



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Infermeiri”

ofruar nga

Universiteti “Western Balkans”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Glodiana Sinanaj

Dr. Julian Kraja

Tetor/ 2025

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.askal.al

E-mail: info@askal.al

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM


Për Programin e studimit Bachelor në “Infermieri” ofruar “Universiteti Western Balkans”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Western Balkans”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Infermieri”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UAMS Nr.423, datë:14.07.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	N/A
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike (6 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip dhe anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2022-2023:17 PAE/6 PAK V.a 2023-2024: 20PAE/11PAK V.a 2024-2025:25 PAE/11PAK
18	Numri i studentëve:	V.a 2022-2023:17 studentë gjuhë shqipe/ 6 studentë gjuhë angleze V.a 2023-2024:23 studentë gjuhë shqipe/11 gjuhë angleze

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



		V.a 2024-2025:16 studentë gjuhë shqipe/ 70 gjuhë angleze
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

WBU u krijua në vitin 2021 si një institucion i arsimit të lartë me fokus të veçantë në Mjekësi, Shkenca mjekësore teknike, Teknologji, Ekonomi dhe Inovacion, ku mësimdhënia është planifikuar të jepet në dy gjuhë (shqip dhe anglisht). WBU si institucion jo publik i arsimit të lartë është hapur me VKM nr. 679, datë 10. 11. 2021. WBU është i akredituar më 19. 04. 2024, me VBA nr. 75. WBU bazon veprimtarinë e vet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni neni 57, pika 6,7) dhe në Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015.

Njësitë Kryesore të Universitetit Western Balkans janë:

- Fakulteti i Mjekësisë Dentare;
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;
- Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit.


Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ku ofrohet dhe programi i studimit Bachelor në “Infermieri”, ka në përbërjen e vet:

1. Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazherisë;
2. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë;
3. Departamenti i Mjekësisë;
4. Departamenti i Kirurgjisë ;
5. Qendra Kërkimore Shkencore për Kërkimin e Semundjeve të Rralla.

Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë. Kjo Njësi bazë ofron po ashtu programe studimi:

1. Bachelor në Teknikë Laboratori (shqip & anglisht);
2. Bachelor në Teknikë Imazherie (shqip & anglisht);
3. Bachelor në Fizioterapi (shqip & anglisht);
4. Master i Shkencave në Infermieri me pesë profile;
5. Prograam i Integruar i Ciklit të Dytë në Mjekësi.

Misioni i FSHMT është për të arritur ekselencë në kërkimin shkencor dhe edukimin e profesionistëve të së ardhmes, për të mirën e individit dhe shoqërisë, duke synuar promovimin



e zhvillimit të qëndrueshëm dhe kujdesit shëndetësor, duke nxitur përparimin, mirëqenien dhe inovacionin në të gjitha fushat në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë.

Strategjia e Departamenti të Infermierisë dhe Fizioterapisë ka për qëllim të pozicionohet si një lider në vend në fushën e edukimit në shëndetësi, kërkimit dhe shërbimeve për komunitetin në gjashtë vitet e ardhshme. Ky plan strategjik paraqet misionin, vizionin, vlerat kryesore dhe objektivat strategjike për të arritur cilësi të shkëlqyera arsimore, për të nxitur kërkime inovative dhe bashkëpunimin me komunitetin. Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” ofrohet që prej vitit 2022 bazuar në Nr.423, date:14.07.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Infermieri”. Bazuar në Urdhërin nr. Nr.32, datë 27.03.2025, nr. 24/3 prot, të ASCAL, “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti Western Balkans”, grupi i vlerësimit të jashtëm për këtë program studimi përbëhet nga, Dr. Glodiana Sinanaj dhe Dr. Julian Kraja. Gjatë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Alma Arapi.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti Western Balkans (WBU), për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 “Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.824, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41 datë 24.01.2018 e ndryshuar “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për “Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”, Udhëzimin e MASR Nr. 22, datë 3.9.2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë” si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

Gjatë vizitës së kryer në institucion, në datat 15 dhe 16 Prill 2025, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit, takime ndër të cilat mund të përmendim atë me, Dekanin e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, Përgjegjës të Departamentit, stafin akademik, studentët, përfaqësues të NJSBC, përfaqësues të Degës së

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës, si dhe përfaqësues të Sekretarisë Mësimore. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura. Në përfundim të analizës së materialeve të sipër cituara, GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi duke paraqitur edhe disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Universiteti “Western Balkans”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 03.10.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 24 / 39 Prot, datë 03.10.2025. Universiteti “Western Balkans”, njofton në ASCAL më datë 08.10.2025, me anë të shkresës me Nr.675/1 Prot, datë 08.10.2025 “ Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Infermieri”

1. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programet e studimit që ofrohen nga Universiteti “Western Balkans” (WBU) nuk bien ndesh me interesat kombëtare. WBU vepron në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore. Misioni i WBU (Statuti i WBU, neni 4) synon formimin e profesionistëve të së ardhmes, të fokusuar në të mirë dhe në funksion të individit dhe shoqërisë, si edhe angazhimi për të qënë një universitet i spikatur ndërkombëtarisht në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit, me qëllimin kryesor të përmirësimit të vazhdueshëm të jetës. Evidenca: - Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit “Western Balkans”
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. WBU ka si mision të ofrojë shërbime në përputhje me misionin e vet. Një nga objektivat kryesor të WBU është kërkimi, mësimdhënia e kontributi për shoqërinë dhe të punojë për përmirësimin e vazhdueshëm të tyre. Ky program formon Infermierë me formim të përgjithshëm, në përputhje me misionin madhor të FSHMT-së, që arrihet nga mësimdhënia dhe kërkimi shkencor që realizohen në një mjedis të tillë që individët të zhvillojnë vlerat e tyre njerëzore, kompetencën gjuhësore dhe aftësitë profesionale (rregullore FSHMT neni 2).

	Evidenca: - Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit te Shkencave Mjekesore Teknike
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Strategjia e WBU ka objektiva transformin me ndikim pozitiv në shoqëri dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendeve përmes ekselencës dhe inovacionit të vazhdueshëm në kërkimin shkencor, arsimin, kujdesin shëndetësor, kreativitetin dhe sipërmarrjen (vizioni). Gjithashtu misioni i tij është për të arritur ekselencë në kërkimin shkencor dhe edukimin e profesionistëve të së ardhmes, për të mirën e individit dhe shoqërisë, duke synuar promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe kujdesit shëndetësor, duke nxitur përparimin, mirëqenien dhe inovacionin në të gjitha fushat në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë. Strategjia e Departamenti të Infermierisë dhe Fizioterapisë ka për qëllim të pozicionohet si një lider në vënd në fushën e edukimit në shëndetësi, kërkimit dhe shërbimeve për komunitetin në gjashtë vitet e ardhshme. Ky plan strategjik paraqet misionin, vizionin, vlerat kryesore dhe objektivat strategjike për të arritur cilësi të shkëlqyera arsimore, për të nxitur kërkime inovative dhe bashkëpunimin më komunitetin. Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” ofrohet në përputhje me këtë strategji. Programi i studimit ofrohet në përputhje me Rregulloren e WBU (Neni 1) si dhe Rregulloren e Njësisë Kryesore (Neni 16 & 17). Sigurimi i cilësisë është një nga pikat kryesore të strategjisë së Institucionit. Evidenca: - Evidenca Nr.1.4 Plani Strategjik i WBU-së 2023-2030 - Evidenca Nr.1.5 Plani Strategjik i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë 2025-2030 - Evidenca Nr.1.10 Rregullorja mbi organizimin akademik të Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit te Shkencave Mjekesore Teknike
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në	WBU u krijua në vitin 2021 si një institucion i arsimit të lartë me fokus të veçantë në Mjekësi, Shkenca mjekësore teknike, Teknologji, Ekonomi dhe Inovacion, ku mësimdhënia është planifikuar të jepet në dy gjuhë (shqip dhe anglisht).



fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	WBU si institucion jo publik i arsimit të lartë është hapur me VKM nr. 679, datë 10. 11. 2021. WBU është i akredituar më 19. 04. 2024, me VBA nr. 75. Godina në të cilën ofrohet ky program studimi është e përshtatshme dhe gjendet në Rugën Tiranë-Durrës, Km 7, Kashar, Tiranë. Gjithashtu, ambjente të tjera janë Spitali Amerikan I, II, III dhe Spitali Ndërkombëtar Hygeia. Për vitin akademik 2022-2023 ka 17 (shtatëmbëdhjetë) pedagogë personel akademik efektiv PAE dhe 6 (gjashtë) janë personel akademik me kontratë PAK. Nga stafi PAE 11 (njëmbëdhjetë) janë të kategorisë Dr, 6 (gjashtë) të kategorisë Msc. Nga stafi PAK 1 (një) është i kategorisë Dr, 5 (pesë) të kategorisë Msc. Raporti PAE/PAK është 17/6. Për vitin akademik 2023-2024 ka 20 (njëzet) pedagogë personel akademik efektiv PAE dhe 11 (njëmbëdhjetë) janë personel akademik me kontratë PAK. Nga stafi PAE 1(një) është i kategorisë Prof.Asoc, 13 (trembëdhjetë) të kategorisë Dr, 6 (gjashtë) lektorë të kategorisë Msc. Nga stafi PAK 2 (janë) të kategorisë Prof.Asoc, 3 (tre) të kategorisë Dr, 6(gjashtë) lektorë të kategorisë Msc. Raporti PAE/PAK është 20/11. Për vitin akademik 2024-2025 ka 25 (njëzet e pesë) pedagogë personel akademik efektiv PAE dhe 11 (njëmbëdhjetë) janë personel akademik me kontratë PAK. Nga stafi PAE 14 (katërmëdhjetë) janë të kategorisë Dr, 11 (njëmbëdhjetë) janë të kategorisë Msc. Nga stafi PAK 2 (janë) të kategorisë Prof.Asoc, 3 (tre) të kategorisë Dr, 2(dy) lektorë të kategorisë Msc.Spa dhe 3 (tre) të kategorisë Msc. Raporti PAE/PAK është 25/11. <i>Pavarësisht se numri i stafit është i gjithnjë në rritje (që është një gjë shumë pozitive), ka një paqëndrueshmëri të tij, GVV konsideron se stafi me kohë të plotë duhet të shtohet. Pjesa më e madhe e personelit janë me tituj dhe grada dhe kjo është një pikë e fortë e këtij programi.</i> Laboratorët e Departamentit janë të disponueshëm për realizimin e këtij programi studimi. Evidenca:
--	--

	- Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit “Western Balkans” - Evidenca - Vendim Per akreditimin e pare te Institucionit te Arsimit te Larte , Universiteti Western Balkans - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.4.1 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit (Aneks. Tabela Përmbledhëse, Tabela 6.1-6.3 dhe 7) - Evidenca – RVB Bachelor Infermieri
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike. Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Njësisë Bazë. Njësia Kryesore përbëhet nga këto njësi bazë; 1. Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazherisë; 2. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; 3. Departamenti i Mjekësisë 4. Departamenti i Kirurgjisë 5. Qendra Kërkimore Shkencore për Kërkimin e Semundjeve të Rralla Ndërsa Njësia bazë ku ofrohet programi Infermieri, ofron po ashtu programe studimi: Bachelor në Fizioterapi, në Shqip dhe Anglisht; Master i Shkencave në Infermieri, në Shqip dhe Anglisht; Programi i studimit është në përputhje dhe me Njësinë Kryesore. Evidenca: - Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike - Evidenca Nr.1.6 Struktura organizative e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike - Evidenca Nr.1.5 Plani Strategjik i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë 2025-2030

	- RVB Bachelor Infermieri			
Konkluzione	<i>Programet e studimit që ofrohen nga Universiteti "Western Balkans" (WBU) nuk bien ndesh me interesat kombëtare. WBU vepron në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore. Misioni i WBU (Statuti i WBU, neni 4) synon formimin e profesionistëve të së ardhmes, të fokusuar në të mirë dhe në funksion të individit dhe shoqërisë, si edhe angazhimi për të qënë një universitet i spikatur ndërkombëtarisht në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit, me qëllimin kryesor të pëmirësimit të vazhdueshëm të jetës.</i> <i>Pavarësisht se numri i stafit është i gjithnjë në rritje (që është një gjë shumë pozitive), ka një paqëndrueshmëri të tij, GVJ konsideron se stafi me kohë të plotë duhet të shtohet. Pjesa më e madhe e personelit janë me tituj dhe grada dhe kjo është një pikë e fortë e këtij programi.</i> <i>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Njesisë Bazë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	WBU ka në Rregulloren dhe Statutin e vet Njësitë akademike dhe administrative specifike të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim mbarëvajtjen e programit të studimit. Secila Njësi ka të përcaktuara detyrat dhe rolin e vet. Me qëllim ofrimin e këtij programi studimi, Njësitë bashkëpunojnë me njëra tjetrën. Kjo u raportua dhe në takimet e zhvilluara në Institucion. Rregullorja e Njesisë Kryesore përcakton rolet e të gjitha njësive në nivel Fakulteti. Ka një mungesë të rregullores së Njesisë Bazë, por që ka Planin Strategjik të Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë 2025-2030 përcaktohen rolet dhe detyrat në nivel departamenti. Evidenca:

	- Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit te Shkencave Mjekesore Teknike - Evidenca Nr.1.5 Plani Strategjik i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë 2025-2030 - Evidenca Nr.1.6 Struktura organizative e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike - Evidenca Nr.1.10 Rregullorja mbi organizimin akademik të Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.11 Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Evidenca Nr.3.10 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC - Evidenca Nr.3.36 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale - Evidenca Nr.3.37 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore - Evidenca Nr. 4.12 Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit - Evidenca Nr. 4.34 Rregullat e Bibliotekës në Universitetin “Western Balkans” - Evidenca Nr. 4.39 Rregullorja e Zyrës së Prokurimeve dhe Shërbimeve Administrative - Evidenca Nr.5.9 Rregullorja e Bursave - Evidenca Nr.5.13 Rregullore për njohjen dhe transferimin e studimeve - Evidenca Nr.5.29 Rregullorja e Zyrës së Studentëve Ndërkombëtarë - Evidenca Nr.3.15 Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART-WBU - Evidenca Nr.3.17 Udhëzimi për procesin e sekretimit të provimeve gjatë vitit akademik - Evidenca Nr. 4.3 Udhëzimi për ngarkesën mësimore në Universitetin “Western Balkans” - Evidenca Nr.5.20 Udhëzimi i Zyrës së të Diplomuarëve
--	--

	- Evidenca Nr.6.5 Udhëzimi mbi Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor - <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Me qëllim formimin e studentëve, dy spitale private: Spiatali Amerikan I, II, III dhe Spitali Ndërkombëtar Hygeia, janë në dispozicion të studentëve të WBU, ku ata formohen sidomos në funksion të praktikës profesionale. Në takimet e zhvilluara me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë, u informuam se ka mbikqyrës së praktikës profesionale që ndjekin studentët në terren. Gjithashtu WBU raporton marrëveshje bashkëpunimi për pjesëmarrjen në vizita studimore në Rrjetin e Klinikave “Median” Gjermani dhe pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit në program shkëmbimi në Chieti, Itali. <i>Megjithatë GVJ sugjeron marrëveshje bashkëpunimi Erasmus +, që si studentët dhe stafit të kenë mundësi shkëmbimi eksperiencash.</i> Evidenca: - Evidenca Nr.1.7 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të WBU-së - Evidenca Nr.1.8 Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU me Shoqërinë American Hospital SH.A dhe shoqërinë International Hygea Hospital SH.A - Evidenca Nr.2.5 Lista e personelit asistent lektor per realizimin e praktikave - Evidenca Nr.3.32 Raporti mbi pjesëmarrjen në vizitën studimore në Rrjetin e Klinikave “Median” Gjermani - Evidenca Nr.3.33 Raport mbi pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit në program shkëmbimi në Chieti, Itali - <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike,	Zhvillimi i praktikave profesionale realizohet në ambientet e Spiataleve Amerikan I, II, III dhe Spitali Ndërkombëtar Hygeia. WBU ofron mundësitë më të mira për zhvillimin e praktikave profesionale. Gjithashtu ka dhe marrëveshje të shWBUs me shumë kompani, organizata dhe universitete të tjera. <i>Por ky institucion nuk ka marrëveshje me sistemin parësor. GVJ rekomandon që të krijohen marrëveshje me parësorin, pasi këta infermierë të ardhshëm duhet të kenë dhe një përgatitje praktiko-profesionale në sistemin parësor.</i>



praktikave të punës apo stazhit etj.	Evidenca: - Evidenca Nr.1.7 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të WBU-së - Evidenca Nr.1.8 Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU me Shoqërinë American Hospital SH.A dhe shoqërinë International Hygea Hospital SH.A - Evidenca Nr.3.24 Manuali i Praktikave Profesionale - Evidenca Nr.3.26 Model i zhvillimit të praktikës profesionale - Evidenca Nr.2.5 Lista e personelit asistent lektor per realizimin e praktikave
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti ka hartuar një raport mbi përfitimet nga marrëveshjet egzistuese. Ajo përmban institucionin që është nënshkruar marrëveshja, qëllimin, përfitimet, data e nënshkrimit si dhe afati i marrëveshjes. Evidenca: - Evidenca Nr.1.16 Raporti vjetor i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë 2022-2023 dhe 2023-2024
Konkluzione	<i>WBU ka në Rregulloren dhe Statutin e vet Njësitë akademike dhe administrative specifike të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim mbarvajtjen e programit të studimit. Secila Njësi ka të përcaktuara detyrat dhe rolin e vet. Me qëllim ofrimin e këtij programi studimi, Njësitë bashkëpunojnë me njëra tjetrën.</i> <i>Gjithashtu WBU raporton marrëveshje bashkëpunimi për pjesëmarrjen në vizita studimore në Rrjetin e Klinikave "Median" Gjermani dhe pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit në program shkëmbimi në Chieti, Itali. Megjithatë GVJ sugjeron marrëveshje bashkëpunimi Erasmus +, që si studentët dhe stafi të kenë mundësi shkëmbimi eksperiencash.</i> <i>Me qëllim formimin e studentëve, dy spitale private: Spitali Amerikan I, II, III dhe Spitali Ndërkombëtar Hygeia, q ë janë në dispozicion të studentëve të WBU, ku ata formohen sidomos në funksion të praktikës profesionale.</i> <i>Por ky institucion nuk ka marrëveshje me sistemi parësor. GVJ rekomandon që të krijohen marrëveshje me parësorin, pasi këta infermierë të ardhshëm duhet të kenë dhe një përgatitje praktiko-profesionale në sistemin parësor.</i>


Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Neni 50, pika a, e Rregullores Themelore së WBU, programet e ciklit të parë të studimit realizohen me 180 kredite dhe me kohëzgjatje normale tre vite akademike. Ky është një program studimi (neni 51) është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS). Një vit ka 60 ECTS dhe studenti realizon 1500 orë punë (gjithësej 4500 orë). Aktiviteti përfshin në total 4500 orë nga të cilat 2065 orë në auditor dhe 2435 jashtë auditorit. Ky raport është në rakordim me VKM 41 pika 2,ç. Nga plani mësimor lëndët janë ndarë në: Lëndë Bazë (35 kredite, 19%), Lëndë Karakterizuese (97 kredite, 54%), Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose Integruese (23 kredite, 13%), Lëndë Plotësuese (19 kredite, 11%) dhe Detyrime Përmbyllëse (6 kredite, 3%). GVJ konstatoi se shpërndarja e veprimtarive formuese në % e Planit mësimor për programin e studimit Bachelor në “Infermieri” është e organizuar sipas VKM 41, 2018. Evidenca: - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - RVB Bachelor Infermieri


Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Misioni i programit mësimor Bachelor në “Infermieri” është të formojë Infermierë me formim të përgjithshëm, në përputhje me misionin e WBU, që është formimi i profesionistëve të së ardhmes, të fokusuar në të mirë dhe në funksion të individit dhe shoqërisë “Statuti i Universitetit “Western Balkans”” Neni. 3). Gjithashtu Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë ka për qëllim të pozicionohet si një lider në vënd në fushën e edukimit në shëndetësi, kërkimit dhe shërbimeve për komunitetin në gjashtë vitet e ardhshme. Ky plan strategjik paraqet misionin, vizionin, vlerat kryesore dhe objektivat strategjike për të arritur cilësi të shkëlqyer arsimore, për të nxitur kërkime inovative dhe bashkëpunimin me komunitetin (Plani Strategjik i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë 2025-2030). Kurrikula e këtij programi studimi ka një kohëzgjatje të rregullt të planifikuar në 6 semestra dhe me një numër në total 180 Kredite (Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” Neni 15, pika 3). <i>GVJ rekomandon që rregulloret e programeve mësimore të jenë të ndara, bachelor dhe master më vete. Gjithashtu si rregullore e programeve, departamentit dhe fakultetit, duhet të përmbajnë në të “Misionin” e tyre.</i> Evidenca: - Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.5 Plani Strategjik i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë 2025-2030 - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Evidenca Nr.2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri”
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me	Nga plani mësimor lëndët janë ndarë në: Lëndë Bazë (35 kredite, 19%), Lëndë Karakterizuese (97 kredite, 54%), Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose Integruese (23 kredite, 13%), Lëndë Plotësuese (19 kredite, 11%) dhe Detyrime Përmbyllëse (6 kredite, 3%), të ndara në 6 semestra dhe me një numër në total 180 Kredite <i>GVJ konstatoi se shpërndarja e veprimtarive formuese në % e Planit mësimor për programin e studimit Bachelor në</i>



ngarkesën përkatëse në kredite.	<i>“Infermieri e Përgjithshme” është e organizuar sipas VKM 41, 2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga LAL”. Megjithatë ngelet detyrë e departamentit që kjo kurrikul të pëshatet me ndryshimet në bazë të VKM 823, datë 28. 12. 2023 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar!</i> Evidenca: - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Evidenca Nr.2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri”
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Neni 84, i Rregullores themelore së WBU përcakton se përfundimi i një programi Bachelor përmbyllet me provim të përgjithshëm ose punim diplome në varësi të pragut të notës mesatare. Ndërsa Rregullore e Njesisë Kryesore nuk përmendet diplomimi. Ndërsa në Rregulloren e programit të studimit (neni 32) thuhet se studenti i cili ka kaluar me sukses të gjitha lëndët e paraqitura në programin mësimor të fakultetit, pajiset me diplomën përkatëse. <i>GVJ konstaton se ka një mungesë të informacionit nëpër rregullore për:</i> <i>Si organizohet provimi i diplomës;</i> <i>Në sa sezone bëhet ai; në tre sesione diplomimi të cilat</i> <i>Kush përcakton datat e diplomimit;</i> <i>nga Dekani i Fakultetit.</i> <i>Nqs nuk kalon provimin final, ku ka të drejte të paraqitet në provim në sezonin e ardhshëm. Etj.</i> Përsa i përket Praktika profesionale, ato trajtohen në Manualin e praktikave profesionale, ku thuhet se një studentet duhet të ketë të paktën 360 orë në praktikë klinike. Kjo është e parashikuar dhe në Programin e bachelor në “Infermieri” dhe ka 10 kredite. Evidenca: - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike



	- Evidenca Nr.2.1 Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë" - Evidenca Nr.2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Infermieri" - Evidenca Nr.3.24 Manuali i Praktikave Profesionale
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	NA
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Bachelor në "Infermieri" ka ngjashmëri me programe të tjera të së njëjtës fushë që ofrohen në IAL të tjera publike e private. Kjo u konfirmua dhe në takimin e zhvilluar me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë. Përmbajtja në nivelin 70% nuk është ende përfunduar nga MAS. Evidenca: - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë.</i>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	WBU ka bërë kodifikimin sipas udhëzimit të MAS. Në përfundim të këtij procesi, do të zhvillohet dhe kodifikimi i lëndëve. Evidenca: - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë.</i>
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas	NA



dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	Ky është një program studimi (neni 51) i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS). Një vit ka 60 ECTS dhe studenti realizon 1500 orë punë (gjithësej 4500 orë). Aktiviteti përfshin në total 4500 orë nga të cilat 2065 orë në auditor dhe 2435 jashtë auditorit. Ky raport është në rakordim me VKM 41 pika 2,ç. Kurrikula e këtij programi studimi ka një kohëzgjatje të rregullt të planifikuar në 6 semestra dhe me një numër në total 180 Kredite (Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” Neni 15, pika 3). <i>GVJ rekomandon që rregulloret e programeve mësimore të jenë të ndara, bachelor dhe master më vehte. Gjithashtu si rregullore e programeve, departamentit dhe fakultetit, duhet të përmbajnë në të “Misionin” e tyre.</i> Nga plani mësimor lëndët janë ndarë në: Lëndë Bazë (35 kredite, 19%), Lëndë Karakterizuese (97 kredite, 54%), Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose Integruese (23 kredite, 13%), Lëndë Plotësuese (19 kredite, 11%) dhe Detyrime Përmbyllëse (6 kredite, 3%). <i>GVJ konstatoi se shpërndarja e veprimtarive formuese në % e Planit mësimor për programin e studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” është e organizuar sipas VKM 41, 2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Megjithatë ngelet detyrë e departamentit që kjo kurrikul të përshtatet me ndryshimet në bazë të VKM 823, datë 28. 12. 2023 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar!</i> Neni 84, i Rregullores themelore së WBU përcakton se përfundimi i një programi Bachelor përmbillet provim të përgjithshëm ose punim diplome në varësi të pragut të notës mesatare. <i>GVJ konstatorn se ka një mungesë të informacionit nëpër rregullore për organizimin e provimit të diplomës.</i> <i>Programi i studimit Bachelor në “Infermieri e përgjithshme” ka ngjashmëri me programe të tjera të së njëjtës fushë që ofrohen në IAL të tjera publike e private.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Të gjitha detyrimet ligjore në fuqi përmbushen për ofrimin e këtij programi studimi. WBU si institucion jo publik i arsimit të lartë është krijuar me VKM nr. 679, datë 10. 11. 2021 WBU është i akredituar nga ASCAL sipas detyrimit ligjor, më 19. 04. 2024, me VBA nr. 75. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ku ofrohet dhe programi i studimit Bachelor në “Infermieri”, ka në përbërjen e vet: 1. Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazherisë; 2. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; 3. Departamenti i Mjekësisë 4. Departamenti i Kirurgjisë 5. Qendra Kërkimore Shkencore për Kërkimin e Semundjeve të Rralla Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” ofrohet që prej vitit 2022 bazuar në Urdhër Nr.423, datë:14.07.2022 të MAS. Për vitin akademik 2022-2023 ka 17 (shtatëmbëdhjetë) pedagogë personel akademik efektiv PAE dhe 6 (gjashtë) janë personel akademik me kontratë PAK. Nga stafi PAE 11 (njëmbëdhjetë) janë të kategorisë Dr, 6 (gjashtë) të kategorisë Msc. Nga stafi PAK 1 (një) është i kategorisë Dr, 5 (pesë) të kategorisë Msc. Raporti PAE/PAK është 17/6. Për vitin akademik 2023-2024 ka 20 (njëzet) pedagogë personel akademik efektiv PAE dhe 11 (njëmbëdhjetë) janë personel akademik me kontratë PAK. Nga stafi PAE 1(një) është i kategorisë Prof.Asoc, 13 (trembëdhjetë) të kategorisë Dr, 6 (gjashtë) lektorë të kategorisë Msc. Nga stafi PAK 2 (janë) të kategorisë Prof.Asoc, 3 (tre) të kategorisë Dr, 6(gjashtë) lektorë të kategorisë Msc. Raporti PAE/PAK është 20/11. Për vitin akademik 2024-2025 ka 25 (njëzet e pesë) pedagogë personel akademik efektiv PAE dhe 11 (njëmbëdhjetë) janë personel akademik me kontratë PAK.

Nga stafi PAE 14 (katërbëdhjetë) janë të kategorisë Dr, 11 (njëmbëdhjetë) janë të kategorisë Msc.

Nga stafi PAK 2 (janë) të kategorisë Prof.Asoc, 3 (tre) të kategorisë Dr, 2(dy) lektorë të kategorisë Msc.Spa dhe 3 (tre) të kategorisë Msc.

Raporti PAE/PAK është 25/11.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ku bën pjesë programi i studimit BSC në “Infermieri” ka në përbërjen e tij për vitin akademik 2024-2025 staf si më poshtë:

Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë	2024-2025	
	PAE	PAK
Prof.dr	1	-
Prof.Asc.Dr	2	-
Dr/Doc	17	2
Msc	23	20
Totali	43	22

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë për tri vitet akademike ka në përbërjen e tij:

Tituj/Grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.dr	-	-	-	1	-	-
Prof.Asc.Dr	2	-	1	-	1	-
Dr/Doc	2	2	2	2	3	4
Msc	4	8	5	12	7	12
Totali	8	10	8	15	11	17


Evidenca:

- Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit “Western Balkans”
- Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit “Western Balkans”
- Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike
- Evidenca Nr. 4.1 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit (Aneks. Tabelat Përmbledhëse, Tabelat 6.1-6.3 dhe 7)
- *RVB Bachelor Infermieri e Pergjithshme;*

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Neni 6 i Rregullores së Njesisë kryesore përcakton rolin dhe detyrimet e drejtuesit të praktikës i cili është personel akademik me kohë të plotë. Kjo njësi ka rekrutuar 5 mbikqyrës së praktikës profesionale (mentorë, pedagogë me kohë të pëllojë) dhe ka kontratë me spitale për udhëheqjen e praktikave nga infermierët e punësuar aty. Për mbikqyrjen dhe mbarëvatjen e praktikave profesionale, ky program ka përgatitur dhe Manualin e Praktikave profesionale që bën të mundur ndjekjen dhe vlerësimin e studentit. Stafi mbikqyrës së praktikës profesionale i raportuar nga Institucioni janë staf i spitaleve dhe kjo është një pikë e fortë për këtë program studimi. Por vihet re që nuk ka as marrëveshje dhe as planifikim të praktikave profesionale nën parësor. GVJ rekomandon që të planifikohen dhe zhvillimi i praktikave në mjediset e shërbimit parësor pasi produkti i këtij programi studimi është infermier që mund të punojë në qendra shëndetësore. Evidenca:4 - Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike - Evidenca Nr.1.14 Manualët e praktikave EPIC - Evidenca Nr.1.9 Manualët e Laboratoreve - Evidenca Nr.3.24 Manuali i Praktikave Profesionale - Evidenca Nr.2.5 Lista e personelit asistent lektor për realizimin e praktikave - Evidenca Nr.1.8 Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU me Shoqërinë American Hospital SH.A dhe shoqërinë International Hygea Hospital SH.A - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në bazë të Rregullores së departamentit, Koordinatori i programit të studimit nuk ekziston, por është shefi i departamentit përgjegjës për ecurinë dhe mbarëvatjen e programit dhe praktikave profesionale. Ai informon dekanin për problematikat e ndryshme. Studentët referuan se kanë një student president që transmeton problemet e ndryshme që mund të hasen. GVJ konsideron vendosjen e një koordinori për këtë program studimi. Evidenca: - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i>

	- Takim me studentët.			
Konkluzione	<i>Të gjitha detyrimet ligjore në fuqi përmbushen për ofrimin e këtij programi studimi.</i> <i>Departamenti ka në përbërje staf ndihmës akademik. Nuk ka një koordinator të programit të studimit dhe GJVJ konsideron se Njësia Bazë duhet të vendosë një koordinator për këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Dokumentacioni i nevojshëm për ofrimin e këtij programi studimi është i disponueshëm nga Njësia Bazë. Statuti dhe Rregullorja e Institucionit përcaktojnë rregullat e përgjithshme ndërsa me më shumë informacione për këtë program studimi (Bachelor në "Infermieri") paraqiten në Rregulloren e Njesisë Kryesore dhe në rregulloren e programit të studimit. Në takimin e zhvilluar me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë ata raportuan se i gjithë dokumentacioni është i disponueshëm pranë Njesisë Bazë përfshirë rregulloren, planin mësimor, syllabuset si dhe literaturën bazë. Evidenca: - Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit "Western Balkans" - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans" - Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë" - Evidenca Nr.2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Infermieri"
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm	<i>Ky është një program studimi me 180 kredite (ECTS).</i> <i>Aktiviteti përfshin në total 4500 orë nga të cilat 2065 orë në auditor dhe 2435 jashtë auditorit.</i>



për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.

GVJ konstaton se raporti orë në auditor me orë individuale është në përputhje me VKM 41 pika 2,ç.

Lëndë Bazë (35 kredite, 19%), Lëndë Karakterizuese (97 kredite, 54%), Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose Integruese (23 kredite, 13%), Lëndë Plotësuese (19 kredite, 11%) dhe Detyrime Përmbyllëse (6 kredite, 3%).

Plani mësimor prezanton lëndët nëse janë semestrale apo vjetore, kategorinë (A-E), nr. e provimeve, kreditet, ndarja e orëve në kredite, ndarja e orëve në semestër dhe totalin e orëve në auditor.

Bsc në "Infermieri"	Viti I	Viti II	Viti III	Në total
Në auditor	675	715	675	2065
Leksione	360	390	390	1140
Seminare	150	115	120	385
Laboratore	135	45		180
Praktika profesionale	30	165	165	360
Punë e pavarur e studentit	825	785	825	2435
Gjithsej	1500	1500	1500	4500


Evidenca:

- Evidenca Nr.2.1 Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë"
- Evidenca Nr.2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Infermieri"

Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

Neni 3, pika 3.3, i Statutit së Institucionit raporton se në programet e studimit pranohen studentë vendas dhe të huaj ndërsa detajet për pranimin e tyre përfshihen në rregulloren e programit të studimit. Neni 66 i rregullores themelore së Institucionit WBU përcakton mundësinë e transferimit të studimeve ndërsa në Rregulloren e Njesisë Kryesore, në nenet 9 raportohet mbi transferimet e mundshme si dhe njohjeve të krediteve.

Në rregulloren e programit të studimit neni 5 përcakton "politikat e pranimit dhe regjistrimit t dhe regjistrimit të studentit" dhe neni 34 përcakton shkëputjen dhe ndërprerjen e



	studimeve. Kriteret e pranimit dhe kuotat për program studimi miratohen nga Senati Akademik. Evidenca: - Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Evidenca Nr.5.14 Procedurë e transferimit të studentëve në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri”
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Asnjë nga rregulloret nuk përcakton kush është i detyruar të hartojë programin mësimor të lëndës, plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij. <i>GVJ konsideron që në rregullore të parashikohen këto gjëra.</i> Syllabuset përmbajnë, titullin e modoulit, lektorin, ngarkesën, kohën e realizimit, llojin e lëndës, një përmbledhje dhe rezultatet e të nxënës, konceptet themelore dhe temat e lëndës. Metodologjia e mësimdhënies, forma e kontrollit të dijeve, literatura dhe kodi i etikës paraqitet në syllabuset e dorëzuara. Në takimin me stafin akademik ata raportuan se çdo fillim viti dorëzojnë syllabuset me ndryshimet/përmirësimet përkatëse. Një kopje e syllabusit i vete dhe Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave. Evidenca: - Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Evidenca Nr.2.2 Model sylabusi i lëndës “Praktikë Profesionale”

	- Evidenca Nr.2.8 Sylabusi i një lënde në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - Evidenca Nr.2.11 Sylabus model i një lënde (lende karakterizuese) - Evidenca Nr.3.34 Sylabus i lëndës “Teza e diplomës Provim përfundimtar” për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - <i>Takim me stafin akademik.</i> - <i>Takimi me Zyrën e Kurrikulave</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” ofrohet që prej vitit 2022 bazuar në VKM nr. 679, datë 10.11.2021. Programi i studimit është në proces përmirësimi të vazhdueshëm. Kjo u përmend në takimin me Drejtuesit e Njësisë Kryesore/Bazë. Ata raportuan se në fillim të çdo viti akademik bëhen rregullime nëse është e nevojshme, pasi miratohen në Departament. Studentët raportuan se ata pyeteshin nga pedagogët për mundësi përmirësimi të programit të lëndëve. Në takimin e zhvilluar me përfaqësuesit e Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin, ata raportuan se bëjnë shkrësë për të identifikuar ndryshimet në syllabus. Në takimin me stafin akademik ata raportuan se çdo fillim viti dorëzojnë syllabuset me ndryshimet/përmirësimet përkatëse. Një kopje e syllabusit i vete dhe Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave. Evidenca: - Evidenca Nr.2.2 Model sylabusi i lëndës “Praktikë Profesionale” - Evidenca Nr.2.8 Sylabusi i një lënde në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - Evidenca Nr.2.11 Sylabus model i një lënde (lende karakterizuese) - Evidenca Nr.3.34 Sylabus i lëndës “Teza e diplomës Provim përfundimtar” për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - <i>Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët;</i> - <i>Takim me përfaqësuesit e Kurrikulave Mësimore.</i>
Konkluzione	<i>Dokumentacioni i nevojshëm për ofrimin e këtij programi studimi është i disponueshëm nga Njësia Bazë. Ky është një program i ciklit të parë dhe ka në total 180 kredite (ECTS).</i>

	Asnjë nga rregulloret nuk përcakton kush është i detyruar të hartojë programin mësimor të lëndës, plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij. GVJ konsideron që në rregullore të parashikohen këto gjëra. <i>Plani mësimor prezanton lëndët nëse janë semestrale apo vjetore, kategorinë (A-E), nr. e provimeve, kreditet, ndarja e orëve në kredite, ndarja e orëve në semestër dhe totalin e orëve në auditor. Syllabuset ishin të përditësuara në literaturë kishin gjithë elementet e parashikuara në VKM 41, 2018.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të metejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Misioni i programit mësimor Bachelor në “Infermieri” është të formojë Infermierë me formim të përgjithshëm, në përputhje me misionin madhor të Njesisë kryesore, që është të rrisë standartet e shëndetit komunitar nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe komunikimit. Ky program mësimor synon formimin profesional të infermierëve që ata të jenë plotësisht kompetentë për të përmbushur nevojat që parashtron profesioni i tyre, në një mjedis dinamik të kujdesit shëndetsor komunitar. Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij dhe mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në kurset teorike dhe praktike për arsye të karakterit të mirëfillt shkencor të tij dhe njohurive nga fusha e infermieristikës, duke synuar në përgatitjen ose kualifikimin metejshëm të studentëve për punësim. Në lidhje me punësimin nuk ka të dhënat pasi këtë vit ka dalë dhe produkti i parë, megjithatë ka të dhëna të punësimit të studentëve me kohë të pjesshme në kuadër të praktikave

	profesionale pranë dy spitaleve që zhvillojnë praktikat profesionale. Evidenca: - Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Evidenca Nr.1.15 Lista e studentëve përfitues të programit EPIC 2022-2023 dhe 2023-2024 me praktikë të paguar - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me studentët;</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Ky program studimi synon të ofrojë një formim bazë në fushën e infermierisë që do të shërbejë studentëve si për studime të mëtejshme por edhe për punësim. Ky program studimi ofrohet në tre vite akademike (6 semestra) dhe ka një total 180 kredite. Totali i krediteve konvertohet në 4500 orë brenda dhe jashtë auditorit. Lëndët e modulet e këtij programi studimi janë të ndara në vite/semestra. Secila lëndë ka një numër të caktuar kreditesh. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen objektivat e përgjithshme ndërsa në syllabuset e lëndëve janë të përcaktuara qartë objektivat formuese si dhe rezultatet e të nxënit. Në takimet e zhvilluara në Institucion, u raportua se përmes lëndëve/moduleve, është e mundur arritja e objektivave të këtij program studimi. Evidenca: - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Evidenca Nr.2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - Evidenca Nr.2.2 Model sylabusi i lëndës “Praktikë Profesionale” - Evidenca Nr.2.8 Sylabusi i një lënde në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri”

	- Evidenca Nr.2.11 Sylabus model i një lënde (lende karakterizuese) - Evidenca Nr.3.34 Sylabus i lëndës “Teza e diplomës Provim përfundimtar” për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi i studimit përfshin orë brenda dhe jashtë auditorit. Në total ky program ofrohet në tre vite akademike dhe kërkon angazhimin për 4500 orë nga të cilat 2065 orë në auditor dhe 2435 jashtë auditorit. Programi përfshin teori dhe praktikë. Programi i studimit është i ngjashëm me programe të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë raportuan Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë në takimin e zhvilluar. Në syllabuset e lëndëve përcaktohen qartë orët e teorisë dhe praktikës. Studentët zhvillojnë në total 1140 orë leksione, 385 orë seminare, 180 orë laboratore, 360 orë praktikë profesionale dhe 2435 orë individuale. GVJ konsideron se orët e praktikës profesionale duhet të jenë më të larta. Evidenca: - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Evidenca Nr.2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - Evidenca Nr.2.2 Model sylabusi i lëndës “Praktikë Profesionale” - Evidenca Nr.2.8 Sylabusi i një lënde në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - Evidenca Nr.2.11 Sylabus model i një lënde (lende karakterizuese) - Evidenca Nr.3.34 Sylabus i lëndës “Teza e diplomës Provim përfundimtar” për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave	Disiplinat mësimore të programit të studimit Bachelor në “Infermieri”, janë të organizuara në pesë kategori, nga A tek E. Veprimtaritë formuese grupohen në: Lëndë Bazë (35 kredite, 19%), Lëndë Karakterizuese (97 kredite, 54%), Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose Integruese (23 kredite, 13%), Lëndë

formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Plotësuese (19 kredite, 11%) dhe Detyrime Përmbyllëse (6 kredite, 3%). Neni 3, pika 3.3 i Statutit të Institucionit raporton se në programet e studimit pranohen studentë vendas dhe të huaj ndërsa detajet për pranimin e tyre përfshihen në rregulloren e programit të studimit. Neni 66 i rregullores themelore së Institucionit WBU përcakton mundësinë e transferimit të studimeve ndërsa në Rregulloren e Njesisë Kryesore, në nenet 9 raportohet mbi transferimet e mundshme si dhe njohjeve të krediteve. Mobiliteti është i mundur në kuadër të këtij programi studimi dhe u raportua nga Drejtuesit e Njesisë Kryesore/Bazë si dhe nga studentët. Gjithashtu ka pjesëmarrje të stafit akademik në këto projekte. GVJ konsideron që WBU duhet të punojë më shumë me studentët në mënyrë që ata të jenë pjesëmarrës në këto mobilitete. Në përfundim të studimeve, punësimi është i mundur pasi studentët janë përfshirë në punë përgjatë praktikave. Evidenca: - Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Evidenca Nr.2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - Evidenca Nr.3.31 Lista e studentëve pjesë e mobiliteteve - Evidenca Nr.3.32 Raporti mbi pjesëmarrjen në vizitën studimore në Rrjetin e Klinikave “Median” Gjermani - Evidenca Nr.3.33 Raport mbi pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit në program shkëmbimi në Chieti, Itali - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me studentët;</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve	Pedagogu i lëndës harton programin mësimor në bazë të objektivave të programit të studimit si dhe në bazë të ecurisë

/moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	së shkencës së infermierisë. Syllabusi dorëzohet dhe miratohet në Departament nga Drejtuesi i Njesisë Bazë. Literatura bazë dhe e rekomanduar përfshihet në të gjithë syllabuset e dorëzuar. Në takimin me studentët, ata raportuan se e frekuentojnë bibliotekën. Biblioteka e pasur i jep mundësi pedagogëve që të përditësojnë syllabuset dhe leksionet e tyre. Gjithashtu dhe studnetët kanë mundësi për gjetjen e literaturës shtesë në funksion të mësimnxënies. Evidenca: - Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Evidenca Nr.2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - Evidenca Nr. 4.32 Rregullorja e Bibliotekës - Evidenca Nr. 4.33 Praktika e kërkesës për pasurimin e fondit të bibliotekës - Evidenca Nr. 4.34 Rregullat e Bibliotekës në Universitetin “Western Balkans” - Evidenca Nr. 4.35 Praktikë për informimin e personelit akademik për cilësinë e fondit fizik dhe fondit online të bibliotekës - Evidenca Nr. 4.36 Raporti vjetor i bibliotekës së WBU 2022-2023, 2023-2024 - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me përfaqësues të Komisionit për Kurrikulat</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” u mundëson studentëve përfitimin e njohirive, aftësive dhe kompetencave të synuara. Objektivat e programit të studimit janë të prezantuara në rregulloren e programit si dhe në syllabuset respektive. Kjo gjë u raportua dhe në takimin e zhvilluar me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë. Përfshirja e teorisë dhe praktikës rrit kompetencat e studentëve për përdorimin e tyre gjatë punësimit. Evidenca: - Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike

	- Evidenca Nr.2.1 Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë" - Evidenca Nr.2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Infermieri" - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë.</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Ky është një program studimi Bachelor në "Infermieri" dhe studentët kanë mundësinë të vazhdojnë studime në ciklin e dytë të studimeve Master profesional apo i Shkencave në përfundim të këtij programi apo të punësohen. Nuk ka të dhëna nga ALUMNI pasi nuk ka produkt të këtij programi. Evidenca: - Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë" - Evidenca Nr.5.18 Praktika e një rasti këshillimi karriere nga Zyra e Planifikimit të Karrierës - Evidenca Nr.2.15 Vendim i Senatit Akademik për miratimin e ngritjes së Bordeve të Tregut të Punës dhe Planifikimit të Karrierës - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Konkluzione	<i>Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale. Ky program studimi ofrohet në tre vite akademike (6 semestra) dhe ka një total 180 kredite. Totali i krediteve konvertohet në 4500 orë brenda dhe jashtë auditorit.</i> <i>Programi përfshin teori dhe praktikë. Studentët zhvillojnë në total 1140 orë leksione, 385 orë seminare, 180 orë laboratore, 360 orë praktikë profesionale dhe 2435 orë individuale.</i> GVJ konsideron se orët e praktikës profesionale duhet të jenë më të larta. Mobiliteti është i mundur në kuadër të këtij programi studimi dhe u raportua nga Drejtuesit e Njesisë Kryesore/Bazë si dhe nga studentët. Gjithashtu ka pjesëmarrje të stafit akademik në këto projekte. GVJ konsideron që WBU duhet të punojë më shumë me studentët në mënyrë që ata të jenë pjesëmarrës në këto mobilitete. Në përfundim të studimeve, punësimi është i

	mundur pasi studentët janë përfshirë në punë përgjatë praktikave.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	WBU ofron programe studimi të përshtatura me tregun e punës. Drejtuesja e Njesisë Kryesore raportoi se janë munduar të përshtasin programet e studimit sipas nevojave. Duke qënë institucion i ri, nuk ka evidenca nga institucioni për përfshirjen e alumnit apo partnerëve në përmirësimin e programit të studimit. Stafi akademik raportoi se rol kryesor në përmirësimin e programit të studimit ka përgjegjësi i departamentit. Në takimin e organizuar me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave ata raportuan se janë përfshirë institucione partnere për përmirësimin e programit të studimit. Përfshirja e këtyre grupeve do ti japë mundësinë WBU të përmirësojë programin e studimit akoma më tepër. Evidenca: - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në	Sipas parashikimeve ligjore, Senati Akademik i WBU, ka në përbërjen e vet dhe studentë, neni 15, pika 4 Statuti i WBU, që është njëkohësisht dhe kryetari i Këshillit Studentor. Institucioni ka ngritur dhe Këshillin studentor. Studentët janë dhe anëtarë të komisioneve të ndryshme që Institucioni ngre (përfshirë këtu edhe procesin e akreditimit). Gjithashtu ekziston senatori i klasës i cili bën urën lidhëse midis studentëve dhe strukturave dhe funksiononte më së miri. Këto u konfirmuan edhe në takimin e zhvilluar me studentët. Nga

ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	ana tjetër, raportuan se kanë gjithnjë një derë të hapur nga Drejtuesia e Njesisë Kryesore në rast se kanë problematika të ndryshme. Vlerësimi i stafit akademik nga studentët është diçka pozitive. Evidenca: - Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.5.22 Përfshirja e studentëve në Senatin Akademik - Evidenca Nr.5.28 Praktikë mbledhjeje me pjesëmarrës përfaqësuesin e klasës (Senatorin) e programit të studimit në Njësinë Bazë - Evidenca Nr.5.27 Ngritja, funksionimi dhe përbërja e këshillit studentor - Evidenca Nr.5.25 Praktika e Zgjedhjeve e Këshillit Studentor 2022 - Evidenca Nr.2.13 Pyetësor për vlerësimin e programit të studimit nga studentët që diplomohen - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Drejtuesit raportuan se mundohen të përditësojnë programin e studimit në bazë të ndryshimeve të fundit. Edhe stafi akademik e raportoi këtë gjatë takimit të zhvilluar. Ata zhvillojnë takime me bashkëpunëtorët e tyre që kanë marrëveshje duke u konsultuar në lidhje me përditësimin e kurikulës. Evidenca: - Evidenca Nr.2.12 Paketa e instrumentave të cilësisë - Evidenca Nr.2.14 Studimi i tregut të punës për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - Evidenca Nr.2.15 Vendim i Senatit Akademik për miratimin e ngritjes së Bordeve të Tregut të Punës dhe Planifikimit të Karrierës - Evidenca Nr.1.7 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të WBU-së - Evidenca Nr.1.8 Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU me Shoqërinë American Hospital SH.A dhe shoqërinë International Hygea Hospital SH.A - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me stafin akademik.</i>

Konkluzione	WBU ofron programe studimi të përshtatura me tregun e punës. Drejtuesja e Njesisë Kryesore raportoi se janë munduar të përshtasin programet e studimit sipas nevojave. Duke qënë institucion i ri, nuk ka evidenca nga institucioni për përfshirjen e alumnit apo partnerëve në përmirësimin e programit të studimit. Stafi akademik raportoi se rol kryesor në përmirësimin e programit të studimit ka përgjegjësi i departamentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Neni 82 i Statutit të WBU, neni 16 i Rregullores së Njesisë Kryesore dhe neni 10, 11, 13 dhe 14 i Rregullores së programit të studimit, përcaktojnë format e mësimdhënies. Ato janë leksionet, seminarët, praktikat profesionale, detyrat e kursit, laboratorët etj. Paralelisht, në këtë program parashikohen 42 lëndë (së bashku me praktikën dhe provimin përfundimtar). Lëndët janë të gjitha të detyrueshme. Plani mësimor përcakton orët e ndryshme për të gjitha format e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në syllabuset e lëndëve përcaktohen orët e dhe formën që përdoret. Këto forma mësimdhënie u konfirmuan dhe në takimet e zhvilluara me stafin akademik, studentët dhe përfaqësues të sektorit të standardeve të cilësisë dhe kurrikulave.

	Bsc në "Infermieri"	Viti I	Viti II	Viti III	Në total
	Në auditor	675	715	675	2065
	Leksione	360	390	390	1140
	Seminare	150	115	120	385
	Laboratore	135	45		180
	Praktika profesionale	30	165	165	360
	Punë e pavarur e studentit	825	785	825	2435
	Gjithsej	1500	1500	1500	4500
	Evidenca: - Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit "Western Balkans" - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans" - Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë" - Evidenca Nr. 2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Infermieri" - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët;</i> - <i>Takim me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave.</i>				
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik përdor mënyra alternative të mësimdhënies me qëllim zhvillimin bërjen e tij sa më të përshtatshëm për studentët. Stafi akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike etj. me qëllim që mësimi të jetë interesant dhe interaktiv. Këto metoda u konfirmuan dhe nga studentët.				
	Evidenca: - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>				



Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Me qëllim përmirësimin e mësimdhënies, WBU, organizon trajnime për stafin akademik. Në takimin me stafin akademik ata raportuan se Zyra e Kërkimit Shkencor ka marrë ekspertë nga jashtë me qëllim zhvillimin e trajnimeve. Paralelisht, u dërgojnë thirrje për aplikime të ndryshme si dhe website. Përfaqsesit e Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave raportuan se organizojnë aktivitete trajnuese, por jo në fushën e didaktikës ndërsa përfaqsesit e Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin raportuan se përmirësimi i mësimdhënies zhvillohet përmes aktiviteteve trajnuese. Evidenca: - Evidenca Nr.2.6 Plani i aktiviteteve të Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë 2023-2024 - Evidenca Nr.3.2 Paketa e trajnimeve të organizuara për kurrikulën dhe mësimdhënien - Evidenca Nr.3.4 Plani i i trajnimeve për stafin akademik dhe administrativ për vitin akademik 2023-2024 - Evidenca Nr.6.13 Pyetësor për vlerësimin e nevojave për trajnime nga personeli akademik - <i>Takim me stafin akademik.</i> - <i>Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> - <i>Takim me përfaqsesit e Zyrës së Kurrikulës.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i cili është i angazhuar në mësimdhënie ka njohuritë dhe aftësitë e duhura. Stafi akademik ka aftësitë e duhura didaktike me qëllim shpjegimin në mënyrën më të mirë të mundshme të studentëve. Studentët raportuan se janë të kënaqur nga mësimdhënia që zhvillon stafi akademik. Stafi akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike etj. me qëllim mësimi të jetë interesant dhe interaktiv. Kjo u konfirmua nga studentët. Gjatë takimit me autoritete drejtuese, ata raportuan se mundohen të rekrutojnë staf me eksperiencë në mësimdhënie. Kjo u raportua dhe në takimin me Burimet Njerëzore. CV-t e pedagogëve tregojnë se ata kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme në mësimdhënie. WBU organizon aktivitete trajnuese për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse të stafit akademik. Evidenca:

	- Evidenca CV-te e personelit akademik te angazhuar ne programin e studimit; - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët; - Takim me përfaqësues të Burimeve Njëerëzore.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Institucioni ka hartuar një pyetësorë për vlerësimin e programit të studimit nga studentët. Kjo është një procedurë standarde që WBU përdor për të përfshirë studentët në përmirësimin e mësimdhënies. Stafi akademik raportoi se ata vlerësohen nga studentët. Ata raportuan se në vija të përgjithsme informohen për rezultatet. Studentët konfirmuan që vlerësojnë stafin akademik. Ata marrin pyetësorin me email dhe e plotësojnë. Kjo është procedura që raportuan dhe përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave. Stafi akademik vlerësohet dhe nga Drejtuesi i Departamentit. Kjo u konfirmua dhe në takimin me stafin akademik. GVJ e konsideron këtë si një praktikë të mirë që WBU duhet të vazhdojë ta bëjë. Evidenca: - Evidenca Nr.2.13 Pyetësor për vlerësimin e programit të studimit nga studentët që diplomohen - Evidenca Nr.6.4 Formular i vetëvlerësimit të stafit - Evidenca Nr.6.8 Formular për vlerësimin e personelit akademik nga kolegët - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët; - Takim me përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave.
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat	Institucioni ka në përbërjen e vet Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave. Ata organizojnë aktivitete të ndryshme duke përfshirë dhe ekspertë të jashtëm. Në takimin me përfaqësues të sektorit, ata raportuan se aktivitetet që organizojnë janë konkrete didaktike. Promovimi i praktikave të mira në mësimdhënie dhe përmirësimin e tyre të vazhdueshëm në WBU e realizont nga njësia kryesore (FSHMT) që kujdeset vazhdimisht të sigurojë trajnime me lektorë vendas dhe të huaj për aplikimin e formave, metodave alternative të mësimdhënies e mësimnxënies në përputhje me fushën dhe natyrën e

dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. Eksperienca shumëvjeçare e personelit akademik është e ndërthurur me personelin e ri duke mundur në këtë mënyrë vijueshmëri të traditës së krijuar por njëkohësisht implementimin e metodave të reja të mësimdhënies. Evidenca: - Takim me përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulav. - Evidenca Nr.6.4 Formular i vetëvlerësimit të stafit - Evidenca Nr.3.13 Lista e plotë dhe raporti i trajnimeve 2022-2023, 2023-2024 - Evidenca Nr.3.4 Plani i i trajnimeve për stafin akademik dhe administrativ për vitin akademik 2023-2024 - Evidenca Nr.3.18 Lista e ekspertëve dhe profesorëve të angazhuar në trajnime në WBU gjatë vitit akademik 2022-2023, 2023-2024 - Takim me stafin akademik;			
Konkluzione	<i>Format e mësimdhënies janë leksionet, seminarët, praktikat profesionale, detyrat e kursit, laboratorët etj. Personeli akademik përdor mënyra alternative të mësimdhënies me qëllim zhvillimin bërjen e tij sa më të përshtatshëm për studentët. Stafi akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike etj. me qëllim mësimi të jetë interesant dhe interaktiv. .</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e	Neni 89 i Rregullores themelore së institucionit dhe neni 20 i Rregullores së Programit të studimit raportojnë kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të dijeve. Në syllabuset e lëndëve/moduleve raportohet se vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm,

programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm: 1. Provimi përfundimtar 50% 2. Provimi të ndërmjetëm 30% 3. Quiz 20% Vlerësimi i tezës së provimit është pjesë e vlerësimit përfundimtar. Vlerësimi përfundimtar bëhet pas përfundimit të procesit të korigjimit të provimit si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studenti përgjatë semestrit, nën përgjegjësinë e titullarit të lëndës. Vlerësimi përfundimtar mund të ndryshohet vetëm me rifutjen në provim për përmirësim. Shkalla e vlerësimit për përvetësimin e dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 4 deri 10) dhe me shkronja (sistemi ECTS me shkronjat nga A deri F). Kjo procedurë u konfirmua nga stafi akademik dhe nga studentët gjatë takimeve të zhvilluara. Vlerësimi detajohet në syllabuset e lëndëve. Evidenca: - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Evidenca Nr.2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - Evidenca Nr.2.8 Sylabusi i një lënde në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - Evidenca Nr.2.11 Sylabus model i një lënde (lende karakterizuese)
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët orën e parë të lëndës informohen nga pedagogu respektiv mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Ky informacion është po ashtu edhe në syllabuset e lëndëve. Informimi i studentëve orën e parë të modulit u konfirmua dhe gjatë takimeve si nga stafi akademik po ashtu dhe nga studentët. Evidenca: - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive,	Sipas nenit 24 të Rregullores së programit të studimit kontrolli i dijes së një lënde bëhet pas përfundimit të çdo semestri.

dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me dorëzim projektsh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë. Në detyrimet e studentit përfshihen të gjitha lëndët. Njohuritë e përfituara nga studenti, mund të kontrollohen dhe të vlerësohen përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, detyrave të kursit, punëve laboratorike dhe provimit me gojë. Vlerësimi në përfundim të secilës lëndë bëhet me pikë (nga 0-100 pikë) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4- 10 ku 4 është notë jo kaluese dhe 10 është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me gërma nga A deri në F sipas sistemit të vlerësimit ECTS me notë. Në syllabusin e çdo lende përcaktohen dhe disiplinohen format e ndryshme të kontrollit të njohurive të cilat zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim, si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët. Evidenca: - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Stafi akademik mundohet të përmirësojë rregullisht format dhe metodat e mësimdhënies. Në këtë proces përfshihen dhe studentët e këtij programi studimi. Stafi akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike etj. me qëllim mësimi të jetë interesant dhe interaktiv. Studentët konfirmuan që vlerësojnë stafin akademik. Ata marrin pyetësorin me email dhe e plotësojnë. Kjo është procedura që raportuan dhe përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave. Stafi akademik vlerësohet dhe nga Drejtuesi i Departamentit. Kjo u konfirmua dhe në takimin me stafin akademik. GVJ e konsideron këtë si një praktikë të mirë që WBU duhet të vazhdoj ta bëjë. Evidenca: - Evidenca Nr.2.13 Pyetësor për vlerësimin e programit të studimit nga studentët që diplomohen

	- Evidenca Nr.3.3 Pyetësor për zhvillimin profesional të personelit akademik dhe administrativ - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët;</i> - <i>Takim me përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulav.</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Autonomia dhe liria akademike është një pikë kryesore të cilën gëzojnë stafi akademik dhe studentët. Mësimdhënia mundohet të fokusohet tek nevojat e studentëve (raportoi stafi akademik), në bazë të objektivave të programit të studimit dhe të objektivave specifike të lëndës ndërsa studentët raportuan se kanë lirinë të shprehin mendimet dhe idetë e tyre gjatë leksioneve/seminareve. Plani mësimor tregon qartë dhe orët e studimit individual në kuadër të këtij programi studimi. Evidenca: - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Evidenca Nr.2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - <i>RVB Bachelor Infermieri e Pergjithshme;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Konkluzione	Në rregulloren e Programit të studimit raportohet se vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të provimi përfundimtar (50%), provimi të ndërmjetëm (30%), (10%) dhe quiz (20%). Studentët orën e parë të lëndës informohen nga pedagogu respektiv mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me dorëzim projektsh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë. Stafi akademik mundohet të përmirësojë rregullisht format dhe metodat e mësimdhënies. Në këtë proces përfshihen dhe studentët e këtij programi studimi. Stafi akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike etj. me qëllim mësimi të jetë interesant dhe interaktiv. Studentët konfirmuan që vlersojnë stafin akademik.



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Neni 89 i Rregullores themelore së institucionit dhe neni 20 i Rregullores së Programit të studimit raportojnë kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të dijeve. Në syllabuset e lëndëve/moduleve raportohet se vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm: 1. Provimi përfundimtar 50% 2. Provimi të ndërmjetëm 30% 3. Quiz 20% Sipas nenit 24 të Rregullores së programit të studimit kontrolli i dijes së një lënde bëhet pas përfundimit të çdo semestri. Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me dorëzim projektsh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë. Vlerësimi në përfundim të secilës lënde bëhet me pikë (nga 0-100 pikë) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4- 10 ku 4 është notë jo kaluese dhe 10 është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me gërma nga A deri në F sipas sistemit të vlerësimit ECTS me notë. Në syllabusin e çdo lënde përcaktohen dhe dispijohen format e ndryshme të kontrollit të njohurive të cilat zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim, si nga pedagoget ashtu dhe nga studentët. Evidenca: - Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë"

	- Evidenca Nr.2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - Evidenca Nr.2.2 Model sylabusi i lëndës “Praktikë Profesionale” - Evidenca Nr.2.8 Sylabusi i një lënde në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - Evidenca Nr.2.11 Sylabus model i një lënde (lende karakterizuese) - Evidenca Nr.3.34 Sylabus i lëndës “Teza e diplomës Provim përfundimtar” për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	WBU ka SMART-WBU për informim të studnetëve. Me qëllim që vlerësimi të jetë i drejtë dhe i paanshëm, përdoret sekretimi i provimeve. Sekretimi u konfirmua nga studentët dhe pedagogët dhe kjo është një pikë e fortë e Institucionit. Evidenca: - Evidenca Nr.3.14 Trajnime të organizuara online mbi përdorimin e SMART-WBU - Evidenca Nr.3.15 Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART-WBU - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi zhvillohet në bazë të nenit 97 të Rregullores Themelore së institucionit dhe nenit 20 të Rregullores së Programit të studimit. Në këto nene raportohen kriteret dhe mënyrat e tesimit dhe vlerësimit të dijeve. Syllabuset përcaktojnë mënyrën e vlerësimit për secilën lëndë/modul. Procedura e vlerësimit siç parashikohet në kuadrin ligjor, u raportua dhe nga stafi akademik e studentët. Evidenca: - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Evidenca Nr.2.2 Model sylabusi i lëndës “Praktikë Profesionale” - Evidenca Nr.2.8 Sylabusi i një lënde në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri”

	- Evidenca Nr.2.11 Sylabus model i një lënde (lende karakterizuese) - Evidenca Nr.3.34 Sylabus i lëndës “Teza e diplomës Provim përfundimtar” për programin e studimit te ciklit te parë “Bachelor” në “Infermieri” - <i>Takim me stafin akademik;</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në përfundimin e provimeve, studentët informohen për rezultatet e provimit në klasë. Studentët raportuan se në rastet që kanë paqartësi mund të pyesin pedagogët për gabimet e tyre. Kjo është një procedurë që u konfirmua dhe nga stafi akademik. Evidenca: - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Përdorimi i matërialeve të ndaluara, kopjimi etj. nuk lejohen. Në sylabuset e lëndëve është i përcaktuar dhe kodi i etikës ku detajohen veprimet që nuk lejohen nga studentët, përfshirë këtu kopjimin, plagjiaturën etj. Kjo u konfirmua nga drejtuesit e Njesisë kryesore dhe Njesisë bazë. Evidenca: - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Studentët informohen mbi rezultatet e provimit sipas afateve ligjore që parashikohen në Rregulloren e programit të studimit. Korrigjimi i provimeve bëhet nën përgjegjësinë e një pedagogu titullar. Pas korrigjimit, provimet depozitohen pranë departamentit dhe vlerësimi i tyre i bëhet i njohur studentëve nëpërmjet pedagogut dhe sekretarisë mësimore të degës përkatëse. Studentët raportuan se njoftohen për pikët e provimit nga pedagogu i lëndës, ose nga sekretaria mësimore. Këtë procedurë e konfirmoi dhe stafi akademik. Evidenca: - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>

Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatin e vlerësimit, të informohen për gabimet e tyre në provim si dhe mundësinë për të kontestuar në rast se nuk janë dakord me vlerësimin. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë, neni 99 i Rregullores Themelore të WBU. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjuara apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të degës përkatëse. Stafi akademik raporoj se ka procedurë për ankimimin e një note por asnjë nga ata nuk kishte patur një çështje të tillë pasi deri tani, çdo problematik ishte mbyllur në nivel Departamenti. Studentët raportuan se janë në dijeni për procedurën e kontestimit të një note, në rast se ata nuk janë dakord. Evidenca: - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans" - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i> -
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Sipas nenit neni 99 i Rregullores Themelore të WBU, çdo ankimim për vlerësim shqyrtohet pasi ka kaluar nga përgjegjësi i departamentit, dërgohet te Dekani i Fakultetit, i cili ngre një komision ad-hoc në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët të cilët kanë korrigjuar provimet. Vendimi lidhur me rivlerësimin e provimit merret brenda 15 ditëve nga dita e depozitimit të ankesës Evidenca: - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans"
Konkluzione	<i>Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të provimit përfundimtar (50%), provimi të ndërmjetëm (30%), (10%) dhe quiz (20%). WBU ka SMART-WBU për informim të studnetëve. Me qëllim që vlerësimi të jetë i drejtë dhe i paanshëm, përdoret sekretimi i provimeve. Sekretimi u konfirmua nga studentët dhe pedagogët dhe kjo është një pikë e fortë e Institucionit. Syllabuset përcaktojnë mënyrën e vlerësimit për secilën lëndë/modul. Procedura e vlerësimit siç parashikohet në kuadrin ligjor, u raportua dhe nga stafi akademik e studentët. Në përfundimin e provimeve, studentët</i>

	<i>informohen për rezultatet e provimit në sistemin Studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatin e vlerësimit, të informohen për gabimet e tyre në provim si dhe mundësinë për të kontestuar në rast se nuk janë dakord me vlerësimin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” garanton thellimin e njohurive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre. Kurrikula e këtij programi studimi ka një kohëzgjatje të rregullt të planifikuar në 6 semestra, 3 vite akademike dhe me një numër në total 180 Kredite. Në vitin e parë zhvillohen lëndët si: gjuhë e huaj, shkenca sociale, informatikë, shkrim akademik, anatomi, fiziologji, biokimi, shkenca, mikrobiologji, të gjitha këto disiplina bëjnë të mundur formimin e përgjithshëm të studentit dhe e përgatit për të studiuar patologjitë. Në vitin e dytë zhvillohen lëndët si: anatomi patologjike, farmakologji, bazat e infermieristikës, sëmundjet të brendshme 1&2, dermatologji, obstetrikë dhe gjinekologji, sëmundje infektive, shëndet mendor, kirurgji 1, psikologji, hemodializë, praktikë profesionale. Në vitin e tretë zhvillohen lëndët si: lende kirurgjikale 2, sëmundje të brendshme 3&4, shëndet publik, urgjencat mjekësore, pediatri, geriatra, praktikat profesionale. Lëndë ndërdisiplinore si Siguria dhe shëndeti në punë, Nutricioni dhe menaxhimi infermioror përfshihen në programin e studimit si lëndë të verpimtarisë C. Evidenca: - Evidenca Nr.2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri”; - <i>Syllabuset Bachelor Infermieri</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të	Ky program studimi fokusohet në përgatitjen e infermierëve për tregun e punës. Lëndë ndërdisiplinore si Siguria dhe shëndeti në punë, Nutricioni dhe menaxhimi infermioror, në

veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	këtë program studimi janë si lëndë në veprimtarinë C. Ndërsa Informatika dhe Gjuhët e huaja janë si lëndë në veprimtarinë D. Evidenca: - Evidenca Nr.2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri”
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në fund të lëndës, pedagogët informojnë dhe orientojnë studentët për çështjet më të rëndësishme. Stafi akademik raportoi se zhvillon konsultime me studentët në orën e fundit të lëndës. Institucioni ka hartuar një raport vjetor, që plotëson stafi akademik në fund të semestrit dhe ku specifikohen objektivat e arritura, literatura e përdorur, frekuentimi, realizimi i programit etj. Kjo është një procedurë shumë e rëndësishme dhe GVJ e konsideron se pikë të fortë. Studentët raportuan se zhvillojnë konsultime me pedagogët. Evidenca: - Evidenca Nr.2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” - Evidenca Nr.1.16 Raporti vjetor i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë 2022-2023 dhe 2023-2024 - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e	Gjatë programit të studimit, studentët përfitojnë njohuri dhe kompetenca. Ata zhvillojnë orë seminare, orë laboratorike dhe praktika. Studentët zhvillojnë në total 1140 orë leksione, 385 orë seminare, 180 orë laboratore, 360 orë praktikë profesionale dhe 2435 orë individuale. Stafi akademik dhe studentët raportuan se diskutimi zhvillohet gjatë orëve të mësimit me qëllim rritjen e aftësive dhe kompetencave të studentëve. Studentët raportuan se pedagogët mundohen të krijojnë një klimë positive duke dhënë dhe shëmbuj/raste konkrete nga puna e tyre klinike. Punimet kërkimore të studentëve janë të mundura të publikohen siç është rasti i një konference në Spanjë, ku 2 pedagogë prezantuan punët e bëra sëbashku me studentët. Evidenca: - Evidenca Nr.2.9 Kurrikula e Programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri”

shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	- Evidenca Nr.3.27 Përfshirja e studentëve në projekte kërkimore - Evidenca Nr.3.33 Raport mbi pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit në program shkëmbimi në Chieti, Itali - Evidenca Nr.3.28 Bashkëpunim me staf akademik të departamentit dhe studentë për implementim studimi, projekti - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Stafi akademik mundohet të zhvillojë orë të hapura dhe seminare mbi të rejtat e shkencës së Infermierisë. Këtë e raportoi stafi akademik në takimin e zhvilluar. Departamenti ka organizuar orë të hapura gjatë periudhës së kaluar dhe kjo është një praktikë e mirë që duhet të vazhdojë ta bëjë. Paralelisht, stafi akademik brenda dhe jashtë strukturës së programit zhvillon studime kërkimore shkencore. Evidenca: - - Evidenca Nr.2.6 Plani i aktiviteteve të Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë 2023-2024 - Evidenca Nr.3.2 Paketa e trajnimeve të organizuara për kurrikulën dhe mësimdhënien - Evidenca Nr.3.29 Trajnimi i zhvilluar për studentët rreth kërkimit shkencor - Evidenca Nr.3.30 Kalendari i veprimtarive të trajnimeve vjetore ekstrakurrikulare të studentëve 2022-2023, 2023-2024 - Evidenca Nr.3.4 Plani i i trajnimeve për stafin akademik dhe administrativ për vitin akademik 2023-2024 - <i>Takim me stafin akademik.</i> - <i>Takim me studentë</i>
Konkluzione	Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” garanton thellimin e njohurive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre. Kurrikula e këtij programi studimi ka një kohëzgjatje të rregullt të planifikuar në 6 semestra, 3 vite akademike dhe me një numër në total 180 Kredite. Gjatë programit të studimit, studentët përfitojnë njohuri dhe kompetenca. Ata zhvillojnë orë seminare, orë laboratorike dhe praktika. Studentët zhvillojnë në total 1140 orë leksione, 385

	orë seminare, 180 orë laboratore, 360 orë praktikë profesionale dhe 2435 orë individuale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Neni 84, i Rregullores themelore së WBU përcakton se përfundimi i një programi Bachelor përmbyllet provim të përgjithshëm ose punim diplome në varësi të pragut të notës mesatare. Në Statutin e WBU, komisioni i provimeve dhe diplomimit propozohet nga Departamenti (neni 52) dhe miratohet nga Dekani (neni 56), dhe kanë përgjegjësinë e realizimit dhe mbarëvajtjes të të gjithë procesit të mbojtjes së diplomës me mikrotezë. Ndërsa në Rregulloren e programit të studimit (neni 32) thuhet se studenti i cili ka kaluar me sukses të gjitha lëndët e paraqitura në programin mësimor të fakultetit, pajiset me diplomën përkatëse. Evidenca: - Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Neni 32, pika 32.1 e Rregullores së programit të studimit, thuhet se studenti i cili ka kaluar me sukses të gjitha lëndët e paraqitura në programin mësimor të fakultetit, pajiset me diplomën përkatëse. Ndërsa pika 32.2 thuhet se studentët të cilët në prag diplomimi kanë jo më pak se tre lëndë (Dose F), u jepet e drejta të përdorin vetëm një herë të drejtën e provimit shtesë për jo më shumë se tre lëndë në të cilat kanë marrë në përfundim të atij semestri.

	Komisioni i propozuar nga Departamenti (neni 52 i Statutit të WBU) dhe i miratuar nga Dekani (neni 56 i Statutit të WBU), ka përgjegjësinë e realizimit dhe mbarëvatjes të të gjithë procesit të mbojtjes së diplomës me mikrotezë. Neni 84, i Rregullores themelore së WBU përcakton se përfundimi i një programi Bachelor përmbyllet provim të përgjithshëm ose punim diplome në varësi të pragut të notës mesatare. Evidenca: - Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.2.1 Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë. - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Komisioni i propozuar nga Departamenti (neni 52 i Statutit të WBU) dhe i miratuar nga Dekani (neni 56 i Statutit të WBU), ka përgjegjësinë e realizimit dhe mbarëvatjes të të gjithë procesit të mbojtjes së diplomës me mikrotezë. Evidenca: - Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit “Western Balkans” - <i>Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton	Neni 84, i Rregullores themelore së WBU përcakton se përfundimi i një programi Bachelor përmbyllet provim të përgjithshëm ose punim diplome në varësi të pragut të notës mesatare. Ndërsa në Rregulloren e programit të studimit (neni 32) thuhet se studenti i cili ka kaluar me sukses të gjitha lëndët e paraqitura në programin mësimor të fakultetit, pajiset me diplomën përkatëse. Evidenca: - Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit “Western Balkans” - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit “Western Balkans”

ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	- Evidenca Nr.2.1 Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë"
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Departamenti suporton studentët në projekte kërkimi duke siguruar asistencë dhe orientim nga pedagogë si dhe materiale për mbledhjen e të dhënave për përgatitjen e temave kryesisht për prezantime në aktivitete si Konferenca, Seminare etj. Studentët kanë mundësi të përdorin kapacitetet dhe infrastrukturën e WBU, për arsye kërkimore. Kjo u konfirmua në takimet në institucion me Drejtuesit e Njesisë Kryesore /Bazë si dhe me studentët. Evidenca: - Evidenca Nr.3.28 Bashkëpunim me staf akademik të departamentit dhe studentë për implementim studimi, projekti - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Bazur në nenin 73, pika 2 e Ligjit 80/2015 të arsmit të lartë, dhe Rreguloret e institucionit, mbrojtja e diplomës për këtë program studimi realizohet me provim të përgjithshëm përfundimtar. Kanë të drejtë t'i nënshtrohen provimit përfundimtar të gjithë studentët që nuk kanë asnjë detyrim akademik të mbartur. Institucioni ndjek një politikë të qartë për zhvillimin me korrektësi të provimeve finale/diplomimit duke ruajtur standardet dhe eliminuar abuzimet. WBU konsideron çdo akt i bërë nga studentët i cili bie ndesh me parimet themelore të vlerësimit dhe meritës në provime. Kopjimi, plagjiatura apo forma të tjera janë të patolerueshme dhe në shkelje të parimeve themelore të institucionit. Në përfundim të punimit të diplomës, studentët vlerësohen me notë. Evidenca: - Evidenca Nr.3.34 Syllabus i lëndës "Teza e diplomës Provim përfundimtar" për programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Infermieri" - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans"
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të	Në përfundimin me sukses të ciklit të studimit dhe mbrojtjes së diplomës, studenti do të pajiset me diplomë universitare të cilësuar me ciklin dhe emërtimin e diplomës së marrë si dhe suplementin e diplomës. Forma dhe përmbajta e dokumentit

miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	të diplomës dhe suplementit i përmbahet udhëzimit Nr.10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elemnetëve përbërës dhe formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit në regjistrin shtetëror të diplomave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor” i ndryshuar me Udhëzimin 14 datë 21.06.2022. të MAS. Gjithashtu studentëve u vihen në dispozicion programi i studimit i detajuar me të gjithë elementët akademikë. Evidenca: - Evidenca Nr.2.3 Vendimi i Senatit Akademik për diplomimin e studentëve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike - Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit “Western Balkans”
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	WBU, konform udhëzimeve për ruajtjen dhe mirë administrimin e të gjithë dokumentave akademike të Institucionit, ruajtja e tyre klasifikohet në bazë të ligjit për arkivat në Republikën e Shqipërisë. WBU arkivon kopje të dokumentacionit të studentit për një afat të pacaktuar dhe jep informacione me kërkesë dhe leje të tij ose të institucioneve shtetërore nëse kërkohen. Kopje e dokumentacionit të studentit ruhet sipas legjislacionit në fuqi. Informacioni mbi studentët (regjistri themeltar, regjistri i arritjeve akademike) ju vu GVJ në dispozicion nga sekretaria mësimore. Evidenca: - <i>Rregullore e sekretarise mesimore;</i> - Evidenca Nr.3.36 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale - Evidenca Nr.1.11 Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit “Western Balkans” - <i>Takim me sekretarinë mësimore.</i>
Konkluzione	Neni 84, i Rregullores themelore së WBU përcakton se përfundimi i një programi Bachelor përmbyllet provim të përgjithshëm ose punim diplome në varësi të pragut të notës mesatare. Në Statutin e WBU, komisioni i provimeve dhe diplomimit propozohet nga Departamenti (neni 52) dhe miratohet nga Dekani (neni 56), dhe kanë përgjegjësinë e realizimit dhe

	mbarëvatjes të të gjithë procesit të mbojtjes së diplomës me mikrotezë. Ndërsa në Rregulloren e programit të studimit (neni 32) thuhet se studenti i cili ka kaluar me sukses të gjitha lëndët e paraqitura në programin mësimor të fakultetit, pajiset me diplomën përkatëse. Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike	Për vitin akademik 2022-2023 ka 17 (shtatëmbëdhjetë) pedagogë personel akademik efektiv PAE dhe 6 (gjashtë) janë personel akademik me kontratë PAK. Nga stafi PAE 11 (njëmbëdhjetë) janë të kategorisë Dr, 6 (gjashtë) të kategorisë Msc. Nga stafi PAK 1 (një) është i kategorisë Dr, 5 (pesë) të kategorisë Msc. Raporti PAE/PAK është 17/6. Për vitin akademik 2023-2024 ka 20 (njëzet) pedagogë personel akademik efektiv PAE dhe 11 (njëmbëdhjetë) janë personel akademik me kontratë PAK. Nga stafi PAE 1(një) është i kategorisë Prof.Asoc, 13 (trembëdhjetë) të kategorisë Dr, 6 (gjashtë) lektorë të kategorisë Msc. Nga stafi PAK 2 (janë) të kategorisë Prof.Asoc, 3 (tre) të kategorisë Dr, 6(gjashtë) lektorë të kategorisë Msc. Raporti PAE/PAK është 20/11.

në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Për vitin akademik 2024-2025 ka 25 (njëzet e pesë) pedagogë personel akademik efektiv PAE dhe 11 (njëmbëdhjetë) janë personel akademik me kontratë PAK.

Nga stafi PAE 14 (katërmëdhjetë) janë të kategorisë Dr, 11 (njëmbëdhjetë) janë të kategorisë Msc.

Nga stafi PAK 2 (janë) të kategorisë Prof.Asoc, 3 (tre) të kategorisë Dr, 2(dy) lektorë të kategorisë Msc.Spa dhe 3 (tre) të kategorisë Msc.

Raporti PAE/PAK është 25/11.

Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-	-	-	-	-
Prof.As.Dr	-	-	1	2	-	2
Dr	11	1	13	3	14	4
MSc	6	5	6	6	11	5
Total	17	6	20	11	25	11

Evidenca:

[Evidenca Nr.4.1 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit (Aneks. Tabela Përmbledhëse, Tabela 6.1-6.3 dhe 7)].

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Personeli akademik efektiv mbulon sipas përcaktimeve ligjore, akteve nënligjore dhe urdhërave të dalë në kuadër të ngarkesës mësimore akademike për stafin akademik, dhe ndihmës akademik. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik në Universitetin "Western Balkans" përcakohet në përputhje edhe të marrëveshjeve të punësimit.

Nga sa më sipër, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL për programin e studimit Bsc në "Infermieri" për vitin akademik 2024-2025 kostatojmë se, **70% e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAE dhe 30% nga PAK.**

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2022-2023	1515	1305	210	56,14% / 13,86%
2023-2024	3215	2185	1030	67,96% / 32,04%

	2024-2025	3810	3110	700	86,87% 18,37%
	Evidenca: [Evidenca Nr.4.2 Ngarkesa totale e personelit akademik të programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Infermieri" gjatë vitit akademik 2022-2023, 2023-2024, 2024-2025 (Aneks. Tabelat Përmbledhëse, Tabela 4)]. [Evidenca Nr.4.3 Udhëzim për ngarkesën mësimore në Universitetin "Western Balkans"]].				
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Gjatë vizitës në Institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem GVJ konstatoi se Institucioni disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit Bsc në Infermieri. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore në dosjet personale të stafit akademik e cila mban dhe marrëveshjen për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semester, dosjen personale si dhe regjistrin themeltarë të stafit. Në regjistrin themeltar të stafit hidhen të dhënat si : data e fillimit të punësimit, ndryshimet e vendit të punës nqs ka deri në largimin dhe tërheqjen. e librezës së punës nga individi. Çdo vit Zyra e Burimeve Njerëzore bën dhe përditësimin e CV të stafit dhe mbledhjen e dokumentacionit plotësues përkatës. Institucioni disponon listën e personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe ngarkesën e tyre mësimore dhe kualifikimin e tyre. Stafi akademik për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Infermieri" (Vitin akademik 2024-2025) është në raportin 25/11, PAE/PAK Evidenca: [Evidenca Nr.4.8 Lista e stafit të angazhuar në programin e studimit me sigurime shoqërore dhe shëndetësore të paguara]. [Evidenca Nr.4.7 Kontrata e punës së personelit akademik].				
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e	Njësia bazë përcakton kriteret për rekrutimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik (me kohë të plotë dhe/ose të pjeseshme). Procedura e konkurimit bëhet konform bazës ligjore dhe nënligjore si dhe me aket e brendshme rregullatore të WBU, sipas modaliteteve të punësimit të përcaktuar në statutin e WBU-së të miratuar nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Rregullat dhe procedurat e hollësishme për punësimin e personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen me rregullore				

personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	të posaçme. Pas përfundimit të procedurave dokumentacioni i përcillet rektoratit i cili harton kontratën e punësimit me personelin akademik. Evidenca: [Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit "Western Balkans" Neni 71-Punesimi i personelit akademik]. [Evidenca Nr.4.14 Praktikë e punësimit në WBU].
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Gjatë vizitës në Institucion dhe disponimit të dokumentacionit në sistem u evidentua angazhimi i personelit ndihmës akademik të cilët asistojnë orët laboratorike dhe gjithashtu realizojnë mbarëvajtjen e laboratoreve të programit të studimit Bachelor në "Infermieri". Personeli akademik është i mjaftueshëm dhe ka kompetencën dhe angazhimin e duhur për realizimin e detyrave të tij. Evidenca: [Evidenca Nr.1.10 Rregullorja mbi Organizimin Akademik të Universitetit "Western Balkans"]. [Evidenca Nr.2.5 Lista e personelit asistent lektor, ndihmës akademik/administrativ i angazhuar për realizimin e praktikave mësimore, për programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Infermieri"].
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër	WBU ka në përbërje të tij personel akademik (me orientim mësimor dhe/ose kërkimor shkencor), personel ndihmës akademik (me karakter mësimor ose administrativ) dhe personel administrativ. Për çdo vit akademik të dhënat e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit ruhen dhe përditësohen vazhdimisht. Këtu bëjnë pjesë angazhimi i çdo anëtarit, i pasqyruar për çdo semestër dhe vit akademik. E njëjta gjë bëhet edhe për personelin ndihmës mësimor dhe administrativ. Evidenca: [Evidenca Nr.1.11 Rregullorja mbi organizimin administrative të Universitetit "Western Balkans"].

dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	WBU Tiranë, prej vitesh është pjesë e një rrjeti spitalor dhe bashkëpunon me Spitalin Amerikan dhe Spitalin Hygea si dhe me institucione të tjera, (për të cilat ekzistojnë dhe kontratat përkatëse), të cilat garantojnë zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike, në sajë të mjediseve të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme. Gjatë vizitës së GVJ u konstatua se synohej së shpejti zhvillimi i bashkëpunimit edhe me Qendrën Spitalore “Nënë Tereza” Tiranë për zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve. Evidenca: [Evidenca Nr.4.16 Lista e institucioneve akademike partnere]. [Evidenca Nr.1.8 Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU-së me Shoqërinë American Hospital SH.A dhe shoqërinë International Hygea Hospital SH. A]. [Evidenca Nr.1.12 Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU-së me Cambridge Clinical Laboratories].
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Personeli mbikqyrës përzgjidhet në mënyrë rigoroze institucionale dhe angazhohet në mënyrë aktive në përmbushjen e realizimit të praktikave profesionale në bazë të marrëveshjes/kontratës. Personeli mbikqyrës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve përfundimtare të praktikës si dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. Në fund studenti vlerësohet për pjesëmarrjen sasiore dhe cilësore aktive duke dhënë edhe vlerësimin përkatës për secilin student. Institucioni u jep suport studentëve nëpërmjet projektit EPIC i cili mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara. Studentë të programit Bachelor në “Infermieri” që kanë kryer praktikat profesionale gjatë vitit akademik 2023-2024 janë gjithsej 66 studentë. Këto praktika profesionale janë zhvilluar nën menaxhimin e përgjegjëses së praktikave MSc.E.Cako pranë institucioneve me të cilat WBU ka një marrëveshje

	bashkëpunimi sic janë: Grupi Spitalor Amerikan dhe Hygea International. Paraqitja e studentëve në këto praktika është me detyrim një herë në javë ditën e Premte rreth 4 orë praktikë nga ora 09:00-13:00. Praktikrat profesionale deri më tani janë zhvilluar në gjuhën shqipe. Evidenca: [Evidenca Nr.1.15 Lista e studentëve përfitues të programit EPIC "2022-2023" dhe "2023-2024" me praktikë të paguar]. [Evidenca Nr.1.14 Manualët e praktikave EPIC]. [Evidenca Nr.3.24 Manuali i Praktikave Profesionale]. [RAPORT VJETOR 2023-2024 DEPARTAMENTI I INFERMIERISË DHE FIZIOTERAPISË].			
Konkluzione	<i>Institucioni garanton qëndrueshmëri në rekrutimin e personelit akademik, si dhe ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit. Personeli akademik që mbulon programin e studimit përmbush standartet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur në përputhje me fushën e programit për garantimin e standarteve të mësimdhënies të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	WBU siguron mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme (shumë të mira) për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Shtirja dhe adaptimi i orarit është bërë në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Evidenca: [Evidenca Nr.4.17 Fragmenti i Hartës Kadastrale të WBU-së]. [Evidenca Nr.4.18 Planimetria e Kampusit Universitar]. [Evidenca Nr.4.10 Akti higjieno sanitar]. [Evidenca Nr.4.11 Akti i mbrojtjes nga zjarri].

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së fundit së informacionit (Smart Board, projektorë me të cilët janë të pajisura të gjitha ambjentet që shfrytëzohen për leksione), që garantojnë realizimin cilësor dhe bashkëkohor të procesit mësimor dhe ndihmojnë në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Konstatim i GVJ gjatë vizitës në ambjentet e WBU. Evidenca: [Evidenca Nr.4.22 Plan shpërndarja e Smart-Boards].
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të studimit në tërësi.	Laboratorët, të cilët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, janë funksionale prej 3 vitesh dhe ndihmojnë në aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formuese të këtij programi studimi. Në WBU në total janë 27 laborator studio etj. Nga këta 6 laboratorë i shërbejnë programit Bsc në Infermieri të cilët janë: Laboratori i Infermierisë dhe Aftësive Mjekësore, Laboratori i Biokimisë dhe Biokimisë Klinike, Laboratori i Fiziologjisë Laboratori i Histo - Patologjisë, i Biologjisë Qelizore, i Mikrobiologjisë, Laboratori i Anatomisë, Laboratori i Shkencave Kompjuterike. Evidenca: [Evidenca Nr.4.23 Lista e laboratorëve të WBU]. [Evidenca Nr.4.24 Inventar Laboratori]. [Evidenca Nr.4.25 Marrëveshja për evadimin e mbetjeve laboratorike].
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale	WBU ka 3 laboratorë të teknologjisë së informacionit (informatikës), të pajisur me programe profesionale të lidhura me natyrën e programit të studimit në Infermieri. Konstatim i GVJ gjatë vizitës në laboratorët e teknologjisë së informacionit në WBU.

sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Evidenca: [Evidenca Nr.3.15 Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit Smart-WBU]. [Evidenca Nr.4.23 Lista e laboratorëve të WBU]. [Evidenca Nr.4.27 Lista e aseteve teknologjike]. [Evidenca Nr.4.28 Dokumenti i abonimit në JSTOR]. [Evidenca Nr.4.29 Aksesit në Research for Life].			
Konkluzione	<i>Institucioni disponon mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3 IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Biblioteka e Universitetit Western Balkan synon të kontribuojë në fushën shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare duke mbështetur arsimin universitar në përputhje me kriteret e nevojshme. Shërben në bllokun B nga ora 8.30 e mëngjesit deri në orën 04.30 të mërkurës, me sallën e madhe të studimit, dhomat e studimit, kompjuterët, burimet e shWBUa dhe aksesin online. Përdoruesit e Bibliotekës janë: > Studentët e Universitetit > Stafi Akademik & Administrativ > Kërkues nga institucione partnere Rregullorja e Bibliotekës është përgatitur dhe synon të ofrojë një shërbim të rregullt dhe efektiv bibliotekar për të përfutur nga burimet e saj. • Titujt e gjetur kryesisht; • Huazimi nga Biblioteka • Përdorimi i burimeve elektronike • Përdorimi i kompjuterëve në bibliotekë • Rregullat e Bibliotekës Për një mjedis të këndshëm dhe efikas kërkimor, rregullorja gjendet në faqen e internetit ose në bibliotekë.

	Stafi i universitetit dhe studentët nuk kanë nevojë të plotësojnë formularin e anëtarësimit përpara se të përdorin bibliotekën në vend. Klasifikimi i Bibliotekës Klasat kryesore janë Q (shkencë), R (mjekësi), T (teknologji), H (shkenca sociale), P (gjuhë dhe letërsi) Përveç këtyre ka edhe A (vepra të përgjithshme), B (filozofi), D (historia botërore), G (gjeografi-antropologji-rekreacion), L (edukim) dhe disa seksione të tjera që lidhen me kurrikulën. GVJ konstaton gjatë vizitës në Institucion se biblioteka ka kushte shumë të mira dhe optimale për studentët dhe stafin. Evidenca: [Evidenca Nr.4.28 Dokumenti i abonimit në JSTOR]. [Evidenca Nr.4.29 Aksesit në Research for Life]. [Evidenca Nr.4.30 Lista e librave (Fondi i Bibliotekës)]. [Evidenca Nr.4.32 Rregullorja e Bibliotekës]. [Evidenca Nr.4.33 Praktika e kërkesës për pasurimin e fondit të bibliotekës]. [Evidenca Nr.4.34 Rregullat e Bibliotekës në WBU]. [Evidenca Nr.4.35 Praktikë për informimin e personelit akademik për cilësinë e fondit fizik dhe fondit online të bibliotekës]. [Evidenca Nr.4.36 Raporti vjetor i bibliotekës së WBU "2023-2024"].
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Gjatë takimeve me Stafin Drejtues u deklarua se çdo fillim viti akademik titullari i lëndës/pedagogu dorëzon në njësinë përgjegjëse programin e studimit Bachelor në "Infermieri" programet lëndore ku jepen detaje mbi literaturën bazë dhe të rekomanduar e cila duhet të jetë e përditësuar me botime bashkëkohore. Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ evidentoi se ajo dispononte numër të lartë të titujve të librave, literatura infermierore dhe mjekësore ishte e pasur në tituj. WBU parashikon çdo vit fonde për blerjen e literaturës së specializuar sipas propozimeve që vijnë nga departamentet dhe në varësi të mundësive financuese. GVJ evidentoi nga dokumentacioni i aploduar se literatura e detyruar dhe e rekomanduar në disa syllabuse është e përditësuar konform rregullores së institucionit dhe njësisë bazë. Ndërkohë është konstatuar mungesa e literaturës së rekomanduar, në disa syllabuse kur literatura bazë është e pesë viteve të fundit.

	<i>GVJ rekomandon plotësimin e atyre syllabuseve që kanë mungesë të literaturës të rekomanduar ta plotësojnë dhe të mundësojnë unifikimin e syllabuseve sipas një formati standard për të gjithë lëndët e programit.</i> Evidenca: [Evidenca Nr.2.8 Sylabusi i një lënde në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri”]. [Evidenca Nr.2.11 Sylabus model i një lënde (lëndë karakterizuese)]. [Evidenca Nr.2.2 Model sylabusi i lëndës “Praktikë Profesionale”].
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka bëhet zgjedhja e parë e të gjithë komunitetit universitar me mjedisin e saj të madh e të gjerë kërkimor me një kapacitet prej më shumë se njëqind personash dhe burimet e saj të ndryshme. Faqja e internetit e bibliotekës është përgatitur me shumë kujdes për të përshkruar bibliotekën e universitetit me gjithçka rreth saj. Mund të aksesohet informacion në detaje, rregullimi i bibliotekës dhe aksesit në burimet online. Research4life (revista, libra, burime referimi, baza të të dhënave) dhe Jstor (revista, libra, imazhe, burime parësore në 75 disiplina) janë shtuar në faqen e internetit me abonim. Evidenca: [Evidenca Nr.4.30 Lista e librave (Fondi i Bibliotekës)]. [Evidenca Nr.4.32 Rregullorja e Bibliotekës]. [Evidenca Nr.4.33 Praktika e kërkesës për pasurimin e fondit të bibliotekës]. [Evidenca Nr.4.34 Rregullat e Bibliotekës në WBU]. [Evidenca Nr.4.35 Praktikë për informimin e personelit akademik për cilësinë e fondit fizik dhe fondit online të bibliotekës].
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista	Gjatë vizitës GVJ evidentoi që Biblioteka e WBU është e pajisur me literaturë fizike universitare, libra dhe revista në gjuhën shqipe si dhe shumë literaturë tjetër ndihmëse në gjuhë të huaj – angleze (libra, revista shkencore etj.) Biblioteka e Universitetit ka mbi 25,000 burime të shtypura. Janë në fazën e regjistrimit dhe deri më tani janë regjistruar afro 6300 libra.

shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Numri i përafërt i burimeve sipas lëndës; Shkenca Mjekësore; 8800 (2800 revista) Inxhinieri; 950 Ekonomi & Biznes; 1550 (150 revista) Teknologji; 1050 (100 revista) Gjuhë & Letërsi; 1140 Shkencat humane; 12080 Burimet Online; Aktualisht janë 36 në dispozicion, studentët mund të përdorin ato nga seksioni i burimeve online të faqes së internetit të Bibliotekës. Burimet Elektronike; Megjithatë GVJ rekomandon që biblioteka të pasurohet me botime të fundit dhe me tituj të rinj. Evidenca: [Evidenca Nr.4.30 Lista e librave (Fondi i Bibliotekës)]. [Evidenca Nr.4.32 Rregullorja e Bibliotekës]. [Evidenca Nr.4.34 Rregullat e Bibliotekës në WBU].
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	WBU ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën fizike dhe online, akses të barabartë e pa pagesë. Biblioteka e Universitetit ka mbi 25,000 burime të shtypura. Burimet Online; Aktualisht janë 36 në dispozicion, studentët mund të përdorin ato nga seksioni i burimeve online të faqes së internetit të Bibliotekës. WBU ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë, si të bibliotekës fizike ashtu dhe asaj online. Evidenca: [Evidenca Nr.4.30 Lista e librave (Fondi i Bibliotekës)]. [Evidenca Nr.4.32 Rregullorja e Bibliotekës]. [Evidenca Nr.4.28 Dokumenti i abonimit në JSTOR]. [Evidenca Nr.4.29 Aksesit në Research for Life]. [Evidenca Nr.4.34 Rregullat e Bibliotekës në WBU].
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka është e pajisur me kompjutera, programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike dhe që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. Evidenca: [Evidenca Nr.4.27 Lista e aseteve teknologjike].

Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët ashtu dhe për pedagogët. Gjatë vizitës në institucion, nga GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara çdo ditë të javës, orare këto në përshtatje me programet e studimit dhe nevojat e studentëve. Biblioteka e WBU shërben për studentët në bllokun B nga ora 8.30 e mëngjesit deri në orën 04.30 të pasdites, me sallën e madhe të studimit, dhomat e studimit, kompjuterët, burimet e shWBUs dhe aksesin online. Dy asistentë të bibliotekës dhe një menaxher ishin gati për të gjetur burimet me interes, për të ndihmuar me nevojat ose për të drejtuar përdoruesit në kërkimet në internet. Përdoruesi i bibliotekës duhet t'i tregojë kartën e studentit personelit të bibliotekës në detyrë, përpara se të hyjë në bibliotekë. Evidenca: [Evidenca Nr.4.34 Rregullat e Bibliotekës në WBU].
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	WBU planifikon çdo vit buxhet të veçantë për pasurimin e fondit të bibliotekës me tituj të rinj apo përditësim të fondit ekzistues në funksion të programit, sipas një plani të detajuar me mbështetjen financiare të akorduar nga drejtoria ekonomike e WBU-së. Propozimet për tituj apo tekste vijnë nga departamente e fakultete dhe përgatiten nga stafi i bibliotekës i cili përgatit listën e teksteve të kërkuara me buxhetin përkatës dhe e dorëzon në rektorat. Gjatë bisedës me stafin akademik dhe studentët u deklarua se ata e shfrytëzojnë në mënyrë të kënaqshme fondin fizik por edhe online të bibliotekës. Evidenca: [Evidenca Nr.1.16 Raporti Vjetor i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë "2023-2024"].
Konkluzione	<i>Njësia bazë realizon çdo vit shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit,</i>

	sipas një plani të detajuar me mbështetjen financiare të akorduar nga drejtoria ekonomike e WBU-së. Gjatë vizitës GVJ evidentoi që Biblioteka e WBU është e pajisur me literaturë fizike universitare, libra dhe revista në gjuhën shqipe si dhe shumë literaturë tjetër ndihmëse në gjuhë të huaj – angleze (libra, revista shkencore etj.) GVJ ka konstatuar mungesën e literaturës së rekomanduar. GVJ rekomandon plotësimin e atyre syllabuseve që kanë mungesë të literaturës të rekomanduar ta plotësojnë dhe të mundësojnë unifikimin e syllabuseve sipas një formati standard për të gjitha lëndët e programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	WBU disponon një sistem të menaxhimit, SMART -WBU nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit Infermieri. Sekretaria mësimore dokumentacionin e ruan në dy forma shkresore dhe elektronike. Ajo është përgjegjëse për regjistrat, hedhjen e të dhënave dhe për marrëdhëniet me studentët. Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, akademike, prodhimin e raporteve statistikore dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale merr informacion për rezultatet e provimeve, rregjistrohet në lëndët që do të frekuentojë apo provimet që do të japë gjatë vitit akademik. WBU për menaxhimin e studentëve dhe të procesit mësimor mban regjistrat e mëposhtëm: ➤ Rregjistër themeltar të studentëve me të dhënat e kërkuara sipas dispozitave ligjore në fuqi. ➤ Rregjistër i notave të marra gjatë ndjekjes së programit të studimit

- Rregjistër i lëshimit të diplomave dhe certifikatave që përmban të dhënat e studentëve që kanë përfunduar programin e studimeve pranë Universitetit "Western Balkans" të dhënat e diplomës dhe suplementit dhe vërtetimin e tërheqjes së këtyre dokumenteve.

Çdo studenti, në momentin e rregjistrimit fillestar pranë WBU, i jepet një numër unik matrikullimi, që e shoqëron deri në marrjen e diplomës ose certifikatës në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Rregjistri themeltar depozitohet në Arkivën e Shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi, ndërsa kopja e njehsuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së Universitetit apo vijimësisë së këtij institucioni me emër të ndryshuar, pa të drejtën e lëshimit të ekstrakteve nga regjistri që nga dita e dorëzimit të tij në arkivën e institucionit; plotësohet edhe në formë elektronike.

Sekretaria mësimore arkivon:

- Dosjet e pranimi dhe rregjistrimit të studentëve me gjithë dokumentacionin përkatë.
- Procesverbale dhe testime në provime.
- Dosjet e diplomimit.
- Dokumentacionin që verifikon plotësimin e kushteve për diploma, procesverbalet e notave të provimit/temave të diplomës.
- Listën e të diplomuarve përcjellë Rektoratit për miratim, fotokopje të diplomave të tërhequra.

Në sistem kanë akses pedagogët, studentët, sekretaria mësimore, Dekani i Fakultetit.

Evidenca:

[Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit "Western Balkans" Neni 122].

[Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkan"].

[Evidenca Nr.1.11 Rregullorja mbi organizimin administrative të Universitetit "Western Balkans"].

[Evidenca Nr.3.37 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore].

[Evidenca Nr.3.15 Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit Smart-WBU].

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	WBU disponon sistemin e brendshëm të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin dhe dokumentacionin që lidhet me aktivitetin e personelit akademik, me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar (regjistrave të kursit, marrvëshja e pedagogut evidencat për realizimin e ngarkesës mësimore) dhe personelit ndihmës akademik. Evidenca: [Evidenca Nr.3.37 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore].
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Nëpërmjet sistemit të menaxhimit sigurohet akses i nevojshëm dedikuar informacioneve dhe dokumenteve për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit Infermieri (nëpërmjet informimit në fillim të vitit akademik për planin mësimor, për shpërndarjen e ngarkesës mësimore, rregullores së studimit, statutit të WBU-së etj.). Evidenca: [Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkan"]. [Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit "Western Balkans"]. [Evidenca Nr.3.15 Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit Smart-WBU].
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. Platformat e integruara që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve bëhen nëpërmjet platformës SMART-WBU-së nëpërmjet të cilave studentëve ju mundësohet akses për vlerësimin e provimeve.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime	Në sistemin e menaxhimit kanë llogari sekretaria mësimore dhe autoritetet drejtuese duke krijuar mundësinë e monitorimit në kohë reale të të gjitha të dhënave dhe mundësinë e gjenerimit të raporteve në lidhje me frekuentimin, rezultatet etj. Kjo llogari mundëson pasqyrimin e aktivitetit akademik semestral dhe komunikimin midis stafit

individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	për problematikat që lindin nga pasqyrimi i vlerësimit në sistem. Komunikimi bëhet kryesisht nëpërmjet adrsave të e-mail, me të cilin është i pajisur i gjithë stafi akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme).			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në gjuhën angleze. Faqja zyrtare e Universitetit Western Balkans është https://WBU.edu.al/ Faqja zyrtare përmban gjithë informacionin kryesor në lidhje me Universitetin; misionin, drejtimin, funksionimin, organogramën. Faqja zyrtare jep informacion mbi fakultetet, kërkimin shkencor, shërbime të tjera që ofrohen nga WBU, programet mësimore që ofrohen sipas departamenteve. Faqja zyrtare përmban informacion të plotë mbi aktivitetet e organizuara nga WBU, stafin akademik, programet mësimore dhe syllabuset e lëndëve bazën ligjore që funksionon WBU, departamentet dhe programet mësimore që zhvillohen në departamente, strukturën e vitit akademik, orari mësimor etj.			
Konkluzione	<i>WBU disponon sistemin e brendshëm të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin dhe dokumentacionin që lidhet me aktivitetin e personelit akademik, me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar (regjistrave të kursit, marrveshja e pedagogut evidencat për realizimin e ngarkesës mësimore) dhe personelit ndihmës akademik.</i> <i>Në sistemin e menaxhimit kanë llogari sekretaria mësimore dhe autoritetet drejtuese duke krijuar mundësinë e monitorimit në kohë reale të të gjitha të dhënave dhe mundësinë e gjenerimit të raporteve në lidhje me frekuentimin, rezultatet etj.</i> <i>Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në gjuhën angleze.</i> <i>Faqja zyrtare e Universitetit Western Balkans është https://WBU.edu.al/</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Çdo vit akademik Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi i cili miratohet nga bordi i administrimit. Fondet burojnë nga buxheti dhe të ardhurat e universitetit. Shpërndarja bëhet në bazë të nevojave që paraqesin njësitë kryesore në bazë të kërkesave të planifikuara në çdo fillim viti akademik. Institucioni gjithashtu harton dhe miraton tarifat e shkollimit të studentëve për çdo program bazuar në VKM përkatëse. GVJ konstatoi të dhëna për financimin e kërkimit shkencor dhe mbështetjen për punën kërkimore shkencore të pedagogëve. Evidenca: [Evidenca Nr.4.38 Buxheti vjetor i WBU për vitin "2023"]. [Evidenca Nr.4.39 Rregullorja e Zyrës së Prokurimeve dhe Shërbimeve Administrative]. [Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit "Western Balkans"]. [Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Eastern Balkan"].
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet	Çdo vit akademik WBU në bazë të kërkesave dhe planifikimeve të Departamentit, harton buxhetin i cili miratohet nga Bordi i Administrimit të Universitetit Western Balkans. Pjesë e buxhetit janë tarifat e shkollimit të studentëve. Institucioni harton dhe miraton tarifat e shkollimit për çdo program bazuar në Nenin 40 gërma C të Statutit të Universitetit Western Balkans me Vendim të Bordit të Administrimit, Nr 8 datë 08/12/2022. Buxheti përfshin pagat e stafit akademik dhe mbështetës, tarifat e shkollimit, studim kërkim zhvillimi shkencor, aktivitete sociale e kulturore, konsulenca të ndryshme, mirëmbajtje dhe riparime, shpenzime zyre, shpenzime komerciale. Evidenca: [Evidenca Nr.4.38 Buxheti vjetor i WBU për vitin "2023"].

financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	[Evidenca Nr.4.39 Rregullorja e Zyrës së Prokurimeve dhe Shërbimeve Administrative]. [Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkan"].
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Institucioni auditohet në mënyrë periodike nga auditit. Në mbështetje të Statusit dhe Rregulloreve të Institucionit në zbatim të Urdhrit Nr.175 datë 13/12/2023 është ushtruar Auditimi i Dokumentacionit në zyrën e Koordinatorës së Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike sipas programit të miratuar nga administratori i Institucionit me qëllim evidentimin e përputhshmërisë së dokumentacionit me kuadrin ligjor. ➤ Shkresat ishin të rregullta dhe të arkivuara ➤ Mbledhjet e Departamentit ishin periodike dhe të arkivuara ➤ Syllabuset e kuseve ishin të nënshkruara dhe të arkivuara ➤ Listprezencat ishin të rregullta dhe të plotësuar ➤ Faqja e internetit ishte e përditësuar ➤ Dokumentacioni i emërimeve dhe ngarkesave mësimore disponohej nga koordinatori. Auditit vlerëson aktivitetin financiar të institucionit. Nga auditimi i dokumentacionit grupi i auditit la si detyra: Të ketë një dosje më vete me aktivitete akademike si Konferencë, Workshop, seminar, leksion i hapur. (Të cilat janë plotësuar si informacion te Raporti Vjetor Institucional për vitin 2022-2023) Evidenca: [Evidenca Nr.4.40 Raporti i auditimit të brendshëm të WBU "2023"]. [Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit "Western Balkans"]. [Evidenca Nr.4.37 Raporti Vjetor institucional për vitin akademik "2022-2023"]. [Evidenca Nr.1.11 Rregullorja mbi organizimin administrative të Universitetit "Western Balkans"].
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse	Institucioni evidenton raportet financiare në mbyllje të çdo viti buxhetor dhe miraton planin e financimit buxhetor në fillim të çdo viti buxhetor, sipas përcaktimeve në aktet ligjore

për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	për funksionimin e tij, duke garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të programit. Evidenca: [Evidenca Nr.1.11 Rregullorja mbi organizimin administrative të Universitetit "Western Balkans"].			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	GVJ bazuar në RVB, referencat përkatëse si dhe takimin me drejtuesit e institucionit konstaton se Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtij programi. Të ardhurat siguroheshin kryesisht nga tarifat e shkollimit, tarifa rregjistrimi, etj. Evidenca: [Evidenca Nr.4.37 Raporti Vjetor institucional për vitin akademik "2022-2023"]. [Evidenca Nr.1.11 Rregullorja mbi organizimin administrative të Universitetit "Western Balkans"].			
Konkluzione	<i>Institucioni evidenton raportet financiare në mbyllje të çdo viti buxhetor dhe miraton planin e financimit buxhetor në fillim të çdo viti buxhetor, sipas përcaktimeve në aktet ligjore për funksionimin e tij, duke garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE


Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe procedurave që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve të programit të studimit Bsc në "Infermieri" nga hyrja në dalje, janë në përputhje me Statutin e Universitetit "Western Balkans", Rregulloren Themelore të Universitetit "Western Balkan", rregulloren e studimeve të Njesisë bazë dhe të gjithë akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Evidenca: [Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit "Western Balkans"]. [Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkan"]. [Evidenca Nr.2.1 Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e Integruara të studimit të ciklit të dytë"].
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	WBU nëpërmjet politikave dhe procedurave, garanton barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit Bsc në "Infermieri". WBU ka të përcaktuara kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit Bsc në "Infermieri". Programi i studimit Bsc në "Infermieri" ka si kritere: ➤ Notën mesatare të shkollës së mesme për të gjitha vitet përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore, përbën 70% të vlerësimit. ➤ Intervista nga komisioni i vlerësimit përbën 30 % të vlerësimit. Kriteret e pranimit janë përzgjedhur bazuar në eksperiencën e Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë si dhe programeve të tjera që ofrohen nga universitete shqiptare dhe të huaja. Evidenca:



	[Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkan" Neni 55]. [Evidenca Nr.5.1 Miratimi i kritereve të pranimit në programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimit].
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	WBU për çdo vit akademik përcakton kriteret specifike për të gjitha programet e studimit që ofron (përfshirë dhe programin Bsc në "Infermieri") për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve, të cilat i përcillen për miratim Senatit Akademik, i cili shprehet me një vendim dhe publikohet online në Web e WBU. Evidenca: [Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkan" Neni 55]. [Evidenca Nr.2.1 Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e Integruara të studimit të ciklit të dytë"].
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret, procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve, përparimi përgjatë kursit të studimit, transferimi, njohja e studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimi i dijeve dhe diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku pasi janë të përcaktuara në rregulloret e studimit të Fakultetit dhe departamentit si dhe online në web të WBU. Evidenca: [Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit "Western Balkans"]. [Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkan" Neni 55]. [Evidenca Nr.2.1 Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e Integruara të studimit të ciklit të dytë"].
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e	Para çdo viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MAS organizohen "ditët e informimit të maturantëve" në gjimnazet kryesore të Tiranës dhe qarqet fqinje të cilat përbëjnë burimin kryesor të studentëve që frekuentojnë WBU. Stafi i ngarkuar për informim organizon takime, shpërndan fletëpalosje ku sqarohen të interesuarit me informacionin e



përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	nevojshëm për kriteret e pranimit apo për çështje të tjera të lidhura me të. Nga ana tjetër kriteret e përgjithshme dhe ato specifike janë lehtësisht të aksesueshme në web e WBU. GVJ konstaton se institucioni ka përcaktuar në rregulloret e departamentit dhe të programit të studimit kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo student që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me VKM. Kandidatët që janë shpallur fitues nga Universiteti Western Balkans, kryejnë finalizimin e regjistrimit në programin e studimit ku janë shpallur fitues në datat e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit pranë Zyrës së Regjistrimit, duke dorëzuar personalisht ose nëpërmjet një personi të autorizuar dokumentacionin e regjistrimit si më poshtë: 1- Kopje e noterizuar e diplomës së shkollës së mesme dhe listë notash; 2- Fotokopje e pasaportës ose kartë identiteti; 3- Certifikatë e gjuhës angleze; 4- Faturë pagese; 5- 2 Fotografi. Studentët e huaj 1- Kopje origjinale e diplomës së shkollës së mesme dhe listës së notave, me vulë apostile, e noterizuar; 2- Kopje e noterizuar e Ekuivalencës së Diplomës; 3- Fotokopje pasaporte; 4- Certifikatë angleze; 5- Kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit; 6- 2 Fotografi; 7- Faturë pagese; Evidenca: [Evidenca Nr.5.5 Miratimi i kriterëve të pranimit për programet e Ciklit të Parë dhe të Dytë të studimit]. [Evidenca Nr.2.1 Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e Integruara të studimit të ciklit të dytë"].
--	--



	[Evidenca Nr.5.6 Guida e studentit].
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	WBU parashikon kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, këto kriteret dhe kuota bëhen publike përpara çdo viti akademik. Bazuar në ligjin nr. 80/2015” Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë, dhe nenit 16 gërma “r” 87 pika 5 të Statutit të WBU me propozim të Bordit të Administrimit. Vendimi nr. 2, Mbledhja 2023/4 datë 12/04/2023. Janë miratuar kuotat e pranimi të studentëve në të gjithë programet e ciklit të parë të studimeve dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë për vitin 2023-2024 në WBU. Mosdiskriminimi i studentëve me aftësi të ndryshme dhe garantimi i respektimit të parimit të barazisë është një ndër parimet e rëndësishme të WBU-së. Universiteti ka siguruar të gjitha facilitetet infrastrukturore dhe shërbimet mbështetëse në përputhje me nevojat e personave me aftësi të ndryshme për studentët në fjalë. Evidenca: [Evidenca Nr.5.7 Kuotat e parashikuara për studentët me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara].
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen nga departamenti në përputhje me aktet nënligjore të MAS dhe në maturën shtetërore, të cilat parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. Kandidatët e huaj që posedojnë një diplomë të shkollës së mesme mund të aplikojnë për pranim në programet e Universitetit Western Balkans. Universiteti pranon një numër të kufizuar të studentëve, në përputhje me kuotat të cilat përcaktohen çdo vit nga departamenti përkatës. Studentët e huaj për tu pranuar në Universitetin “Western Balkans” në programet e zgjedhura nga ana e tyre ndjekin hapat e mëposhtëm: 1- Kopje origjinale e diplomës së shkollës së mesme dhe listës së notave, - me vulë apostile, e noterizuar; 2- Kopje e noterizuar e Ekuivalencës së Diplomës; 3- Fotokopje pasaporte;

	4- Certifikatë angleze; 5- Kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit; 6- 2 Fotografi; 7- Faturë pagese; Evidenca: [Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkan" Neni 55]. [Evidenca Nr.5.2 Procedura e pranimit të studentëve të huaj]. [Evidenca Nr.1.11 Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans"].
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	WBU çdo vit akademik harton dhe realizon procedurë specifike të bursave dhe ndihmës për shtresat në nevojë dhe për studentët ekselentë në varësi të arritjeve akademike. Zyra e Bursave në Dekanatin e studentëve është porta e mundësive për bursa studimore për nxënësit ekselentë që aplikojnë në programet e studimit pranë WBU, për nxënësit me talente të veçanta si dhe për studentët me nevojë ekonomike të cilët duan të ndjekin studimet në WBU. Evidenca: [Evidenca Nr.5.10 Marrëveshja me "Prespektivat e Reja" për bursa]. [Evidenca Nr.1.11 Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans"]. [Evidenca Nr.5.11 Rregullorja e bursave mbi zbritjen e tarifës vjetore të Universitetit "Western Balkans"]. [Evidenca Nr.5.12 Lista e studentëve përfitues të bursave për vitet akademike "2022-2023", "2023-2024", "2024-2025"].
Konkluzione	<i>Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe procedurave që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve të programit të studimit Bsc në "Infermieri" nga hyrja në dalje, janë në përputhje me Statutin e Universitetit "Western Balkans", Rregulloren Themelore të Universitetit "Western Balkan", rregulloren e studimeve të Njesisë bazë dhe të gjithë akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. WBU ka të përcaktuara kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit Bsc në Infermieri.</i> <i>Kriteret, procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve, përparimi përgjatë kursit të studimit, transferimi,</i>

	njohja e studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimi i dijeve dhe diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku pasi janë të përcaktuara në rregulloret e studimit të Fakultetit dhe departamentit si dhe online në web e WBU.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm dhe vlerësimit përfundimtar (provimit), janë të përcaktuara në Rregulloren e Studimeve të WBU. Studentët informohen që në fillim të vitit akademik për kriteret e kalimit nga një vit në tjetrin, numrin e krediteve që duhet të grumbullojnë, ndërsa nëpërmjet sistemit SMART-WBU informohen për vlerësimin në provime. Në rregulloren e Departamentit, rregulloren e programit të studimit, dhe syllabuset studenti gjejnë info të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Në rregullore është e përcaktuar shkalla e frekuentimit e detyruar për programin e studimit. ➤ Frekuentimi i leksioneve dhe seminareve: Për studentët e ciklit të parë është i detyrueshëm në masën 75%, për studentët e ciklit të dytë dhe programeve të integruara është i detyrueshëm në masën 80%. ➤ Frekuentimi i detyrave të kursit, punëve laboratorike dhe mësimi praktik është i detyrueshëm në masën 80%. ➤ Projektet e kursit janë fakultative të shlyhen në masën 100% Studentët të cilët nuk përmbushin këto norma nuk hyjnë në provimin përfundimtar semestral. Studenti kalon nga viti i parë në vitin e dytë, kur ka siguruar të paktën 30 kredite të vitit të parë.

	Studenti kalon nga viti i dytë në vitin e tretë, kur ka siguruar të paktën 60 kredite të vitit të parë dhe të dytë. Studenti në vit të fundit që në përfundim të provimeve të vitit rezulton me 30 kredite të pashlyera në rastet kur ka përmbushur detyrimin e frekuentimit të lëndëve, ka të drejtë ti likujdojë ato në një periudhë të caktuar nga dekanati përpara sezonit të diplomimit. Në të kundërt studenti detyrohet të shlyejë detyrimin e frekuentimit. Studenti i cili nuk plotëson kushtet për të kaluar në vitin pasardhës konsiderohet përsëritës i vitit akademik. Evidenca: [Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit "Western Balkans"]. [Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkan" Neni 81, Neni 90]. [Evidenca Nr.2.1 Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e Integruara të studimit të ciklit të dytë"]. [Evidenca Nr.5.14 Procedurë e transferimit të studentëve në programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Infermieri"].
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme përcaktohen në Rregulloren e WBU dhe specifikohen në Rregulloren e Studimeve në WBU. Komisioni i ekuivalentimit të moduleve dhe programeve bën vlerësimin e dosjeve dhe përgjdhjen e kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara. Në rregulloren e departamentit dhe programit të studimit, studentët kanë info për kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Në të dy rregulloret ka nene specifike për procedurat e transferimit apo të ekuivalentimit të lëndëve si dhe për mundësitë e ndjekjes së programeve të dyta të studimeve. Studentët informohen përmes Sekretarisë Mësimore dhe Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Në departamente ngrihet një komision i posaçëm i cili vlerëson dhe njeh kualifikimet e mëparshme bazuar në dokumentacion i cili përfshin planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve.

	Evidenca: [Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit "Western Balkans"]. [Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkan"]. [Evidenca Nr.2.1 Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e Integruara të studimit të ciklit të dytë"]. [Evidenca Nr.5.13 Rregullore për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve].
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në syllabuset e moduleve përcaktohen elementet e vlerësimit të njohurive, pikëzimi dhe konvertimi në notë. Studentët informohen nga Pedagogu përgjegjës për modulën në fillim të disiplinës. Procedurat e vlerësimit janë të shpjeguara në nenet e rregullores së programit dhe të detajuara në syllabuset e lëndëve. Në disa syllabuse përcaktohet skema e kontrollit të dijeve e cila ndahet në provime gjysmë finale, seminare dhe provim final. Kalendar i provimeve gjysmë finale dhe përfundimtare semestrale përcaktohet nga këshilli i departamentit përkatës. Provimet bëhen zakonisht me shkrim. Pedagogu i lëndës mund të vendosë ta realizojë provimin me gojë, në formë projekti ose detyrë kursi. Vlerësimi i mësimit, laboratorit, projekteve, seminareve dhe punimeve përmbyllesë nga pikpamja akademike bëhet në bazë të njësive matëse orë. Vlera e krediteve të një lënde përbëhet nga orët e plota teorike në javë dhe gjysma e orëve javore të aplikimit, laboratorit dhe projektit. Në takimin me studentët GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur me cilësinë e mësimit dhe transparencën e vlerësimit. Vlerësimi dhe notat e marra kanë qenë korrekte referuan ata. Evidenca: [Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkan"]. [Evidenca Nr.2.1 Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e Integruara të studimit të ciklit të dytë"]. [Evidenca Nr.2.8 Sylabusi i një lënde në programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Infermieri"]. [Evidenca Nr.2.11 Sylabus model i një lënde (lëndë karakterizuese)].



Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në rregulloren e departamentit dhe programit të studimit janë përcaktuar qartë mënyra e diplomimit. Në rregullore përcaktohet: ➤ Diplomimi bëhet me provim përfundimtar ose temë diplome ▪ Për provimin përfundimtar të formimit rregullorja përcakton procedurën e informimit të studentëve për temat e provimit, procedurën e hartimit të tezës, elementët e tezës, procedurën e vlerësimit, ankimimit dhe rivlerësimit. ▪ Për tezën e diplomës rregullorja përcakton karakteristikat dhe strukturën e tezës së diplomës. Kushtet që duhet të përmbushë studenti për marrjen e diplomës dhe procedurën e diplomimit. GVJ konstatoi se emërtimi i diplomës përputhet me programin e studimit dhe objektivat formuese dhe karakterizuese të tij (diploma dhe suplementi i diplomës) Në fillim të vitit të fundit të studimeve, Departamenti përzgjedh në bazë të notës mesatare të dy viteve të para studentët të cilët mundet të paraqiten me temë diplome në provimin e fundit. Udheheqësi i temës së diplomës i përcaktuar nga departamenti përgatit programin e punës dhe konsultimeve me studentin, kandidat për tu diplomuar.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Për çdo vit akademik dhe periodikisht WBU publikon dhe vë në dispozicion informacion mbi programet e studimit që ofron nëpërmjet faqes zyrtare, sekretarisë dhe stafit akademik, në mënyrë që ky informacion të përcillet tek të interesuarit për atë program studimi që mund të kenë interes në të ardhmen. [Faqja web].
Konkluzione	<i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurave të vlerësimit të dijeve, kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit Bsc në "Infermieri".</i> <i>Kriteret dhe procedurat janë të përcaktuara në Rregulloren e Studimeve të WBU. Për çdo vit akademik dhe periodikisht</i>

	<i>WBU publikon dhe ve në dispozicion informacion mbi programet e studimit që ofron edhe nëpërmjet faqes zyrtare.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Në çdo fillim viti akademik studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, për çdo ndryshim të ndodhur duke mundësuar mirë informimin e tyre. Nëpërmjet Sekretarisë Mësimore dhe Sistemit ata gjejnë: ➤ Informacion mbi Institucionin që ofron programin e studimit; ➤ Informacion për objektivat formuese të programit; ➤ Strukturën dhe Organizimin e programit; ➤ Planin mësimor; ➤ Syllabuset; ➤ Rregulloret; ➤ Suplementin e Diplomës. Evidenca: [Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit "Western Balkans"]. [Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkan"]. [Evidenca Nr.2.1 Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e Integruara të studimit të ciklit të dytë"]. [Evidenca Nr.5.17 Praktika e informimit të studentëve nga këshilltari akademik i programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Infermieri"].
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për	GVJ konstaton se dokumentacioni për programin e studimit është i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. Në fillim të çdo viti akademik, studentët informohen për modulet, lëndët, përmbajtjen, numrin e krediteve për secilën lëndë dhe

lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	veprimtarinë formuese. Informimi bëhet nga përgjegjësi i Departamentit ku bën pjesë programi i studimit dhe pedagogu i lëndës përkatëse, informacion i cili mund të jepet edhe më pas nga stafi akademik në vatësi të kërkesave të studentëve. Në syllabuse studenti orientohet për tematikat e lëndës dhe mënyrën e organizimit të orës së mësimi (leksion, seminar, praktikë). Studenti i merr të dhënat si nga sistemi ashtu dhe nga faqja e web e internetit. Studentët e vitit të parë informohen dhe orientohen që në fillim nga Këshilltari akademik dhe grupi i tutoriatit që ai krijon me studentë të viteve të fundit.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në takimin me GVB, GVJ kërkoi informacion mbi mënyrën e orientimit të studentëve për mundësitë e punësimit. Një rol të rëndësishëm luan Zyra e Alumnit. Institucioni ka mundësuar përfshirjen e studentëve në një sërë aktiviteteve informuese në lidhje me kërkesat e punëdhënësve. Pjesëmarrja e studentëve në aktivitete trajnuese brenda dhe jashtë rajonit shton mundësitë e informimit dhe promovimit të studentëve në tregun e punës. Evidenca: [Takimi me GVB]. [Evidenca Nr.1.11 Rregullorja mbi organizimin administrative të Universitetit "Western Balkans"]. [Evidenca Nr.5.18 Praktika e një rasti këshillim karriere nga Zyra e Karrierës]. [Evidenca Nr.5.19 Të dhëna mbi studentët e diplomuar në WBU (programi Master i Shkencave në "Infermieri")]. [Evidenca Nr.5.20 Udhëzimi i Zyrës së të Diplomuarëve].
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në fillim të çdo viti akademik studentëve të sapoardhur u jepet një informacion i gjërë dhe i detajuar mbi mënyrën e organizimit të procesit mësimor (ndarja në leksione/seminare/laboratore), logjistikën, infrastrukturën (sallat e leksioneve/seminareve/laboratoreve) dhe shërbimet ndihmëse në funksion të realizimit të këtij procesi, si dhe organizimi i praktikave profesionale. GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët konstaton që ata informohen gjerësisht dhe në detaje për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimi, aktivitetet jashtë kurrikulare, logjistikën, labororet, modalitetet e praktikave profesionale. Praktika profesionale

	realizohet sipas marrëveshjeve me spitalet private (Amerikan dhe Hygea) synohet për nënshkrimin e marrëveshjeve edhe me spitalet shtetërore, QSUT etj. Në funksion të studentëve është Sekretaria Mësimore dhe Biblioteka. Evidenca: [Vizita në Universitet]. [Evidenca Nr.1.8 Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU-së me Shoqërinë American Hospital SH.A dhe shoqërinë International Hygea Hospital SH.A].			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nëpërmjet platformës SMART-WBU, studentët logohen individualisht dhe njihen lehtësisht dhe në distancë me programin e studimit dhe çështjeve të lidhura me të. Në RVB theksohet se WBU ka një sistem informativ të brendshëm përmes të cilit mundësohet informimi i studentit për programin e studimit. Studenti disponon një kod personal përmes të cilit mund të aksesojë të dhënat e tij në çdo moment veç detajeve për programin e studimit dhe detajeve individuale për notat etj. Evidenca: [Faqja web e programit, Platforma SMART-WBU].			
Konkluzione	<i>Në çdo fillim viti akademik studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, për çdo ndryshim të ndodhur duke mundësuar mirëinformimin e tyre.</i> <i>Në syllabuse studenti orientohet për tematikat e lëndës dhe mënyrën e organizimit të orës së mësimi (leksion, seminar, praktikë).</i> <i>Studenti i merr të dhënat si nga sistemi ashtu dhe nga faqja web e internetit. Studentët e vitit të parë informohen dhe orientohen që në fillim nga Këshilltari akademik dhe grupi i tutoriatit që ai krijon me studentë të viteve të fundit.</i> <i>Nëpërmjet platformës SMART-WBU, studentët logohen individualisht dhe njihen lehtësisht dhe në distancë me programin e studimit dhe çështjeve të lidhura me të.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni, disponon në sekretarinë mësimore statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve në të gjitha programet e studimit, përfshirë dhe programin e studimit Bsc në “Infermieri”. Sekretaria ka: ➤ Regjistrin themeltar të studentëve; ➤ Regjistrin e lëshimit të diplomave; ➤ Regjistrin me të dhënat akademike (regjistri i notave). Në takimin me sekretarinë mësimore u informuam se regjistrat në formë të shkruar depozitohen me kohë të pacaktuar dhe arkivohen në arkivën e shtetit. Në programin e studimit Bachelor në:“Infermieri” në tri vite akademike ka të regjistruar studentë si më poshtë në gjuhën shqipe dhe atë angleze: <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Gjuhë shqipe</th><th>Gjuhë angleze</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>17 studentë</td><td>6 studentë</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>23 studentë</td><td>11 studentë</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>16 studentë</td><td>70 studentë</td></tr></table> Evidenca: [Evidenca Nr.5.21 Lista e studentëve të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” "2022-2023", "2023-2024", "2024-2025"].	Viti akademik	Gjuhë shqipe	Gjuhë angleze	2022-2023	17 studentë	6 studentë	2023-2024	23 studentë	11 studentë	2024-2025	16 studentë	70 studentë
Viti akademik	Gjuhë shqipe	Gjuhë angleze											
2022-2023	17 studentë	6 studentë											
2023-2024	23 studentë	11 studentë											
2024-2025	16 studentë	70 studentë											
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në	WBU disponon statistika të sakta vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të parë “Infermieri” (ashtu sikurse për të gjitha programet e studimit që ofron), si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Këto të dhëna ruhen edhe në sistem dhe menaxhohen nga sekretaria mësimore, nëpërmjet regjistrave të programit të studimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit.												

të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Në sekretari depozitohen dosjet e studentëve të plotësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi, listat e frekuentuesve si dhe një numër dokumentacionesh për procedurat e transferimit, të regjistrimit në programet e dyta dhe të çregjistrimit. Evidenca: [Evidenca Nr.5.21 Lista e studentëve të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri” "2022-2023", "2023-2024", "2024-2025].
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, në kushte të sigurisë së lartë, në të cilin kanë akses personat e autorizuar në varësi të detyrës (sekretaria, pedagogët, IT etj) duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e autorizuar të të dhënave, informacioni personal i studentëve ruhet në mënyrë konfidenciale dhe shpërndahet vetëm për palët e autorizuar në plotësim të kriterëve që përcaktohen në ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” si dhe në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore për Arsimin e lartë si dhe në bazë të rregulloreve të funksionimit të WBU. GVJ konstaton se institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit nga pranimi deri në diplomim. Në sekretarinë mësimore të dhënat arkivohen në rregjistrin e notave si dhe në formë procesverbalesh. Në departamente ruhen regjistrat e lëndëve si dhe procesverbalet e lëndëve. GVJ në takimin me punonjësit e sekretarisë mësimore inspektoi hapësirat e punës dhe arkivimit të dokumentacionit dhe u njoh me një numër dokumentesh si dosja e studentit, dosja e personelit.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të	Rektorati dhe drejtoritë përkatëse që lidhen me organizimin e punës në universitet kryejnë kontrole periodike (auditim të brendshëm) pranë sekretarive mësimore dhe departamenteve për menaxhimin e informacioneve dhe dokumentacioneve (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), ku vlerësohet dhe dokumentohet gjendja dhe saktësia e informacionit dhe dokumentacionit të ruajtur dhe sistemuar. Evidenca:

dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	[Evidenca Nr.4.40 Raporti i auditimit të brendshëm të WBU "2023"].
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti ndjek ecurinë e studentëve gjatë ciklit të plotë të studimeve. Në varësi të nivelit të licensimit departamenti merr masa për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Raportet analitike përpilohen në formën e analizës vjetore. Duke qenë se janë vitet e para të funksionimit të universitetit, Zyra e Alumnit nuk disponon të dhëna për punësimin e të diplomuarëve. Brezi i parë i programit Master i Shkencave në “Infermieri” do të diplomohet këtë vit akademik, ndërsa brezi i parë i programit Bachelor në “Infermieri” dhe “Fizioterapi” do të diplomohet vitin e ardhshëm. Ka kërkesa të mëdha për punësim edhe jashtë Shqipërisë. Me krijimin e zyrës së Alumnit është parashikuar skedim i plotë i informacionit për punësimin. Evidenca: [Evidenca Nr.1.11 Rregullorja mbi organizimin administrative të Universitetit "Western Balkans"]. [Evidenca Nr.3.37 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore]. [Evidenca Nr.1.16 Raporti Vjetor i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë "2023-2024"].
Konkluzione	<i>Institucioni, disponon në sekretarinë mësimore statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve në të gjitha programet e studimit, përfshirë dhe programin e studimit Bsc në “Infermieri”.</i> <i>WBU disponon statistika të sakta vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të parë “Infermieri” (ashtu sikurse për të gjitha programet e studimit që ofron), si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</i> <i>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, në kushte të sigurisë së lartë, në të cilin kanë akses personat e autorizuar në varësi të detyrës (sekretaria, pedagogët, IT etj) duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e autorizuar të të dhënave.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e WBU, Rregullores së WBU dhe Rregullores së Departamentit, studentëve u garantohej e drejta e përfaqësimit nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse dhe këshilluese (senatin akademik, dekanati i studentëve, KIZ, KZF, NJSBC, RVB, komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët etj). Studentët kanë qenë pjesëmarrës dhe në hartimin e RVB. Evidenca: [Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Ëestern Balkan"]. [Evidenca Nr.5.22 Përfshirja e studentëve në Senatin Akademik]. [Evidenca Nr.5.23 Pjesëmarrja e studentëve në organet kolegjiale]. [Evidenca Nr.5.24 Emërimi i studentit në NJSBC]. [Evidenca Nr.5.25 Praktika e Zgjedhjeve e Këshillit Studentor "2022-2023", "2023-2024", "2024-2025"].
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, në WBU është reale, konkrete dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. Verifikimi dhe matja e tyre bëhet nëpërmjet pyetësorëve periodikë që Departamenti dhe Fakulteti organizon me studentët e programit të studimit Bsc në Infermieri. Në takimin me studentët GVJ konstaton se studentët plotësojnë pyetësorë në mënyrë periodike, përfshihen në punë studimore dhe aktivitete promovionale e trajnuese të organizuara nga WBU. Studentët shprehen të kënaqur për

	përfshirjen e tyre dhe angazhimin për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e procesit akademik. Evidenca: [Evidenca Nr.5.27 Ngritja, funksionimi dhe përbërja e këshillit studentor]. [Evidenca Nr.1.11 Rregullorja mbi organizimin administrative të Universitetit "Western Balkans"].
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Përfshirja e studentëve në hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit konsiderohet si shumë e rëndësishme dhe kjo reflekton në pranimin e sugjerimeve dhe kontributin e tyre në këto programe. Në takimin me studentët ata vlerësuan pozitivisht cilësinë e mësimdhënies në kushte shumë të mira dhe me pajisje optimale të teknologjisë së fundit. Studentët gjykojnë se praktikët në laboratorët e teknologjisë së fundit, anatomazhi (laboratori i anatomisë normale) dhe praktikët profesionale në spitalet private i aftësojnë profesionalisht dhe i përgatisin për tregun e punës. Gjatë takimit që pati GVJ me studentët ata kanë shprehur dëshirën e tyre për zhvillimin e praktikave jo vetëm në spitalet private por edhe shtetërore. Studentët kanë nënvizuar si problematikë praktikën (shtimin e orëve në praktikë) dhe Gjuhën Latine e cila duhet të jetë pjesë e kurrikulës Bsc në "Infermieri". GVJ rekomandon që të rishikohet mundësia e shtimit të orëve të praktikës së studentëve si dhe kur të jetë mundësia e ndryshimeve në kurrikul të mundësohet shtimi i Gjuhës Latine. Evidenca: [Evidenca Nr.5.28 Praktikë mbledhjeje me pjesëmarrës përfaqësuesin e klasës (Senatorin) e programit të studimit në Njësinë Bazë].
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe	Studentët gëzojnë të drejtat e tyre të përcaktuara në dokumente rregullatorë. Studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatet e provimeve, me zgjidhjen e tezës së provimit pas provimit, dhe të ndjekin shkallët e ankimimit për rivlerësim. Në varësi të rastit specifik merren masa të reflektimit (rimarrja e studentit në provim nga i njëjti komision ose ngritja e një komisioni tjetër nga departamenti dhe fakultetit). Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit

reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Procedura dokumentohet qartë në RVB. Në takim me GVJ, studentët shprehen të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve (provime me shkrim) dhe me mundësitë që ata kanë për ankimim rezultati dhe rishikimit apo reflektimit nga ana e institucionit /njësisë/pedagogut përgjegjës për rishikim të tezës së provimit. Në bisedat me studentët kur janë pyetur a do të ishte më mirë që të mos ishte barrierë nota shtatë për të kaluar nga një vit në tjetrin: disa u shprehën kjo notë na nxit për të mësuar më shumë, të tjerë mendonin ndoshta do të ishte më mirë të ulej pragu në 6.5. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejtë dhe të përvetësojnë sa më shumë dije.GVJ bazuar në përgjigjet e studentëve në lidhje me notën mesatare të lëndëve (shtatë) rekondon të shikohet mundësia e uljes së pragut të notës mesatare shtatë në 6.5 (të reflektohet në Rregullore). Evidenca: [Evidenca Nr.2.1 Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e Integruara të studimit të ciklit të dytë”].			
Konkluzione	<i>Përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, në WBU është reale, konkrete dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. Verifikimi dhe matja e tyre bëhet nëpërmjet pyetësorëve periodikë që Departamenti dhe Fakulteti organizon me studentët e programit të studimit Bsc në “Infermieri”. Përfshirja e studentëve në hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit konsiderohet si shumë e rëndësishme dhe kjo reflekton në pranimin e sugjerimeve dhe kontributin e tyre në këto programe. Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Institucioni ka njësi të posaçme në informimin e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Studentët informohen nga web i WBU, e cila përditësohet vazhdimisht. Në funksion të informimit të studentëve janë: ➤ Zyra e Këshillimit Akademik që organizon dhe sistemin e tutoratit për studentët e sapo regjistruar. Këshilltari akademik asiston studentët nga momenti i regjistrimit deri tek këshillimi për mundësinë e ndjekjes së programeve të tjera të studimit (master) apo për mundësitë e punësimit. Grupi i tutoratit krijohet nga studentë të viteve të larta dhe asiston studentët e vitit të parë në adaptimin me sistemin e mësimdhënies dhe akomodimin në WBU. ➤ Sekretaria mësimore; është e hapur çdo ditë për studentët dhe ofron shërbim akademik nga regjistrimi në diplomim. ➤ Zyra e studentit: informon studentët për sistemin e bursave, sistemin e akomodimit (konviktet) ➤ Drejtorja e Standarteve dhe Sigurimit të Cilësisë. ➤ Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë ➤ Zyra e IT. ➤ Koordinator i praktikave: koordinon studentët për praktikat në spitalet rajonale. ➤ Faqe web e WBU. Evidenca: [Takimi në institucion] [Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit "Western Balkans"]. [Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkan"]. [Evidenca Nr.1.11 Rregullorja mbi organizimin administrative të Universitetit "Western Balkans"]. [Evidenca Nr.3.37 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore].

	[Evidenca Nr.3.36 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale].
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Këshillimi, ndjekja, përparimi dhe asistimi i studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit bëhet me pedagogët e moduleve përkatëse dhe përgjegjësin e departamentit. Studentët u shprehën të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor, për pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, promovuese dhe trajnuese bashkë me pedagogët. Evidenca: [Takimi në institucion]
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	WBU u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe ALUMNI (që funksionon në shkallë universiteti), mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar atyre informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Zyra e Planifikimit të Karrierës i ndihmon studentët për: ➤ Identifikimin e lidhjeve midis diplomës që do të marrin dhe mundësive për karrierë; ➤ Identifikimin e burimeve për pozicione të veçanta pune; ➤ Zhvillimin e strategjive për mënyrën e të kërkuarit të punës; ➤ Identifikimin e aftësive dhe shprehive. Në këtë zyrë studentët gjejnë mbështetje për përgatitje për intervista pune, shkrimin e CV dhe letrave të motivimit etj. Zyra ofron një seri aktivitetsesh për orientimin e studentëve në tregun e punës si Open Day, Ditët e informimit". Në bashkëpunim me strukturat e tjera akademike, Zyra e Planifikimit të Karrierës ka organizuar aktivitete të ndryshme. Në fillim të vitit zyra parashikon aktivitetet dhe përcakton buxhetin për to; buxheti i dërgohet për miratim Këshillit të Administrimit. Evidenca: [Takimi në institucion]

	[Evidenca Nr.1.11 Rregullorja mbi organizimin administrative të Universitetit "Western Balkans"]. [Evidenca Nr.5.18 Praktika e një rasti këshillim karriere nga Zyra e Karrierës]. [Evidenca Nr.1.15 Lista e studentëve përfitues të programit EPIC "2022-2023" dhe "2023-2024" me praktikë të paguar].			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	WBU duke qenë se është një institucion i ri dhe që nuk ka të diplomuar nga ky program studimi nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe ALUMNI parashikon të gjurmojë dhe të mbledhë të dhëna për punësimin e studentëve të programit të studimit Bsc në "Infermieri". Në takimin e GVJ-së me Zyrën e Planifikimit të Karrierës u informuam se kjo njësi parashikon të ketë një database informacioni për studentët që do të diplomohen. Njësia e këshillimit të karrierës do të mbajë lidhje me studentët që do të diplomohen nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit. Evidenca: [Evidenca Nr.1.11 Rregullorja mbi organizimin administrative të Universitetit "Western Balkans"].			
Konkluzione	<i>WBU u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe ALUMNI (që funksionon në shkallë universiteti), mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar atyre informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e WBU dhe në rregulloren e institucionit. Në RVB evidentohet se politikat e sigurimit të cilësisë detajohen dhe në planet strategjike të institucionit. Objektivat e sigurimit të cilësisë evoluojnë në përputhje me analizën e situatës dhe me qëllimet e objektivat e zhvillimit të institucionit. Senati akademik është aktiv në mbështetje të implementimit të politikave të sigurimit të cilësisë. Në RVB gjejmë evidenca të vendimeve të senatit për aprovimin e pyetsorëve të studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve administrative, vendimeve për aprovimin e formateve të vlerësimit të performancës së stafit akademik dhe ndihmës akademik. WBU kualifikon stafin akademik në fushën e kërkimit, duke e konsideruar këtë si prioritet strategjik në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të mësimdhënies. Personeli akademik trajnohet vazhdimisht për përmirësimin e mësimdhënies, nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të projekteve në të cilat WBU është partner. Trajnimet e planifikuara per Stafin Akademik, Janar 2024 deri në Qershor 2024, WBU Trajnimet ➤ Hapat e hapjes së një qendre apo instituti. Ndërtimi i revistës shkencore. ➤ Cost Action, etj. Programet e Shkëmbimit. ➤ Formulari i aplikimit për projektet Erasmus+ CBHE. ➤ Plotësimi i buxhetit për projektet Erasmus+ CBHE. ➤ Metodologjia e mësimdhënies dhe efektet e saj në të nxënit cilësor,

- Diversiteti dhe Ndërgjegjësimi Kulturor - Dallimet kulturore, festimi i diversitetit dhe promovimi i përfshirjes, Përshtatja ndaj ndryshimit, etj.
- Rendesia e Vlerësimit. Planifikimi, zbatimi dhe përmirësimi i vlerësimit në arsimin e lartë. Vlerësimi.
- Ndërmjetësimi dhe zgjidhja e konfliktit. Komunikim efektiv, bashkëpunim dhe Bashkëpunim në grupe.
- Komunikimi efektiv shkencor. Kërkim shkencor, publikim dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore.
- Si të shkruhet teza, Msc. Udhëzues praktik për shkrimin e disertacionit dhe tezës.
- Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale/Patentat.
- Analiza e të dhënave për kërkimin shkencor.
- Trajnim për mediat transmetuese.
- Sigurimi i cilësisë në Arsimin e Lartë, Paketa e Instrumenteve të Sigurimit të Cilësisë në WBU.
- Konferenca Ndërkombëtare, Arsimi i Lartë dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm.
- Konferenca Ndërkombëtare, Mjekesi Inovative: Mjekësia, Inovacioni dhe Teknologjia

Evidenca:

[Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Ëestern Balkan"].

[Evidenca Nr.2.1 Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e Integruara të studimit të ciklit të dytë"].

[Evidenca Nr.2 Rregullorja e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Infermieri].

[Evidenca Nr.2.8 Sylabusi i një lënde në programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Infermieri"].

[Evidenca Nr.3.13 Lista e plotë dhe raporti i trajnimeve 2022-2023, 2023-2024].

[Evidenca Nr.3.14 Trajnime të organizuara online mbi përdorimin e SMART WBU].

[Evidenca Nr.3.15 Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit Smart-WBU].

[Evidenca Nr.3.3 Pyetësor për zhvillimin profesional të personelit akademik dhe administrative].

[Evidenca Nr.3.2 Paketa e trajnimeve të organizuara për kurrikulën dhe mësimdhënien].

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.

Në bazë të Nenit 35 të Statutit të Universitetit "Western Balkans" me propozim të Rektorit Senati Akademik ka vendosur Miratimin e Anëtarëve të Komisionit të Përherhëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit.

Ky Komision është organi përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik. Komisioni është organi përgjegjës për kryerjen e vlerësimit periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, për monitorimin dhe bashkërendimin e veprimtarive të ndërmarra në kuadër të vlerësimit akademik dhe administrativ për përmirësimin e cilësisë nëpërmjet raporteve të vlerësimit, kontrollit periodik dhe ndjekjes së përmirësimit të cilësisë në Universitet.

Ky komision planifikon dhe koordinon zbatimin e procedurave të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të Universitetit si dhe të programeve të studimit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, standartet shtetërore të cilësisë si dhe rregulloret, udhëzimet, politikat dhe procedurat e universitetit.

Organizon aktivitete trajnuese për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit.(NJSBC), strukturë e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Proceset e sigurimit të cilësisë zbatohen për të gjitha dispozitat e Universitetit "Western Balkans" në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, si edhe në programet e organizuara në bashkëpunim me institucionet e tjera të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit. Përvoja të mësuarit e të gjithë studentëve vlerësohet në mënyrë sistematike, duke reflektuar rregullisht dhe në mënyrë periodike përmirësimet e nevojshme në këto procese.

Garantimi i cilësisë është objektivi kryesor i Universitetit Western Balkans (WBU), i përcaktuar në vizionin dhe misionin e institucionit për një ndikim transformues në shoqëri përmes inovacionit të vazhdueshëm në arsim, kërkimit shkencor, kreativitetit dhe sipërmarrjes.

Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, ka propozuar një paketë instrumentash vlerësues, me qëllim vlerësimin periodik të rezultateve të cilësisë së arsimimit, kërkimit, burimeve njerëzore, financave, infrastrukturës, marrëdhënieve me publikun, marrëdhënieve ndërkombëtare, aktiviteteve

	sociale dhe kulturore, punimeve në kuadër të zhvillimit të cilësisë dhe aktiviteteve përmirësuese në WBU. Kjo paketë konsiston në formate vlerësimi, të kategorizuara sipas nevojës dhe rëndësisë së vlerësimit, duke institucionalizuar kulturën e cilësisë në WBU. [Evidenca Nr.3.7 Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit]. [Evidenca Nr.3.8 Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit]. [Evidenca Nr.3.9 Vendimi për ngritjen e NJSBC]. [Evidenca Nr.3.10 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC]. [Evidenca Nr.2.12 Paketa e instrumentave të cilësisë]. [Evidenca Nr.3.11 Lista e aktiviteteve trajnuese të realizuara sipas rekomandimeve të NJSBC]. [Evidenca Nr.3.12 Plani i aktiviteteve të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë]. [Evidenca Nr.3.13 Lista e plotë dhe raporti i trajnimeve 2022-2023, 2023-2024]. [Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit "Western Balkans"].
--	---



Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.

Në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si edhe në komisione të tjera në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti, ka përfaqësues anëtar të studentëve nga programe dhe cikle të ndryshme studimi. Të drejtat e tyre për t'u përfaqësuar në strukturat e komisioneve të ndryshme në të gjitha këto nivele, si edhe për të bërë ankimime, janë të sanksionuara me dokumente rregullatore.

Ka një pyetësor që zhvillohet në çdo fund viti akademik me studentët e "Western Balkans University". Qëllimi i tij është të vlerësojë nivelin e kënaqësisë së tyre për të ndihmuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësinë së menaxhimit të institucionit.

Dekani i studentëve është përgjegjës për mbarrëvajtjen e marrëdhënieve të studentëve me Universitetin Western Balkans. Ai koordinon aktivitetet socio-kulturore të studentëve dhe kryen detyrat e tij, në bashkëpunim me organet drejtuese. Ai ndihmon në koordinimin mes njësisë akademike dhe administrative për çështjet që prekin drejtpërdrejtë interesat e studentëve.

Vlerëson dhe drejton aplikimet akademike, sociale, profesionale dhe administrative të studentëve në lidhje me jetën në mjediset universitare.

Këshilli i studentëve është një organizim i pavarur. Këshilli i studentëve zgjidhet çdo dy vjet nga vota e studentëve dhe mbështetet në legjislacionin në fuqi.

Këshilli i studentëve shpreh mendime dhe bën propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të Universitetit Western Balkans dhe të fakulteteve, siç janë ato për planet dhe programet e studimeve, për hapjen e programeve të reja, për rregulloret e veprimtarisë mësimore, për cilësinë e shërbimeve, për nivelin e tarifave të shkollimit, për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.

[Evidenca Nr.6.1 Formular i vlerësimit të pedagogut nga studentët].

[Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit "Western Balkans"].

[Evidenca Nr.1.2 Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans"].

[Evidenca Nr.2.1 Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e Integruara të studimit të ciklit të dytë"].

	[Evidenca Nr.3.8 Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit]. [Evidenca Nr.6.2 Rast i planit të masave të ndërmarra nga institucioni bazuar në raportet e vlerësimit të hartuara nga NJSBC].
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është struktura përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë në Universitetin Western Balkans. Përbërja dhe kompetencat e kësaj njësie përcaktohen në Statutin e Universitetit Western Balkans. Mënyra e funksionimit të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përcaktohet në rregulloren përkatëse të miratuar nga Senati Akademik. Kryen studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Universiteti. Në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit është organi përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik. Komisioni është organi përgjegjës për hartimin e standardeve për sigurimin e cilësisë, në përputhje me Kodin e Cilësisë, të cilat miratohen nga Senati Akademik. Komisioni është organi përgjegjës për kryerjen e vlerësimit periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, për monitorimin dhe bashkërendimin e veprimtarive të ndërmarra në kuadër të vlerësimit akademik dhe administrativ, për përmirësimin e cilësisë nëpërmjet raporteve të vlerësimit, kontrollit periodik dhe ndjekjes së përmirësimit të cilësisë në Universitet. Pas çdo vlerësimi, Komisioni raporton para Senatit Akademik rezultatet dhe propozimet përkatëse. Në kuadër të pyetësorit institucional për vlerësimin e institucionit (Evidenca 1.36), studentët kanë vlerësuar: ➤ procesin e zhvillimit akademik në programin e studimit në të cilin janë. ➤ infrastrukturën dhe facilitetet e mundësuar nga institucioni.

	➤ personelin e WBU-së dhe shumëllojshmërinë e aktiviteteve dhe angazhimeve për studentët. ➤ mundësin e ofrimit të një aplikacioni smart, nëpërmjet të cilit studentët të kenë mundësinë të njihen në kohë reale me rezultatet e të nxënës, kurrikulën etj. ➤ nevojën e përmirësimit të infrastrukturës dhe kushteve në lidhje me transportin. [Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit "Western Balkans"]. [Evidenca Nr.3.8 Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit]. [Evidenca Nr.6.2 Rast i planit të masave të ndërmarra nga institucioni bazuar në raportet e vlerësimit të hartuara nga NJSBC].
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	BIP-Blended Program Intensive 17-21 qershor 2024 Western Balkans University siguroi një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin D'Annunzio në Chieti-Pescara, në kuadër të programit Erasmus + të BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin. Marrëveshja u arrit në përpjekje për t'i qëndruar besnik premtimeve dhe për ta çuar Universitetin në një drejtim ku bashkëpunimi, edukimi, shkëmbimi akademik dhe përvoja, kërkimi dhe mësimi janë të mundshme për stafin akademik dhe studentët. Roli multidisiplinar i profesionistëve të kujdesit shëndetësor në kujdesin e integruar ndërmjet spitalit dhe territorit ishte fokusi i aktivitetit. Staf i pjesëmarrës zhvilloi seminare dhe prezantime të mira në një përpjekje për të ofruar informacion të rëndësishëm, për të edukuar mbi mundësitë dhe për të eksploruar mënyrat për të zgjeruar një sistem efikas të kujdesit shëndetësor në territor dhe për të lehtësuar ngarkesën mbi spitalet dhe veçanërisht dhomat e urgjencës. Dita tjetër vazhdoi me një sërë seminaresh që eksploran tema të rëndësishme si menaxhimi i rrezikut klinik midis spitalit dhe territorit, diagnoza dhe menaxhimi i dështimit të zemrës dhe trajnimi dhe aplikimi i infermierëve italianë. Çdo vit akademik, Bordi i Administrimit të Universitetit Western Balkans vendos fondin total të institucionit për mbështetjen dhe nxitjen e publikimeve dhe aktivitetit shkencor të stafit si dhe përcakton gjithashtu nivelin

	maksimal të bonusit financiar individual për publikimet dhe aktivitetet shkencore. GVJ evidentoi dokumentin (Evidenca Nr.3.19) Model të mbështetjes financiare të personelit në pjesëmarrje në aktivitete kërkimore shkencore si dhe Dokumentin (Evidenca Nr.6.6) Model aplikimi për projekt (AKKSHI& CBPHE). [Evidenca Nr.2.6 Plani i aktiviteteve të Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë "2023-2024"]]. [Evidenca Nr.4.12 Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit]. [Evidenca Nr.6.5 Udhëzimi për nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor]. [Evidenca Nr.3.19 Model i mbështetjes financiare të personelit në pjesëmarrje në aktivitete kërkimore shkencore]. [Evidenca Nr.3.13 Lista e plotë dhe raporti i trajnimeve 2022-2023, 2023-2024]. [Evidenca Nr.6.6 Model aplikimi për projekt (AKKSHI& CBPHE)].			
Konkluzione	<i>WBU kualifikon stafin akademik në fushën e kërkimit, duke e konsideruar këtë si prioritet strategjik në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të mësimdhënies. Personeli akademik trajnohet vazhdimisht për përmirësimin e mësimdhënies, nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të projekteve në të cilat WBU është partner.</i> <i>Garantimi i cilësisë është objektivi kryesor i Universitetit Western Balkans (WBU), i përcaktuar në vizionin dhe misionin e institucionit për një ndikim transformues në shoqëri përmes inovacionit të vazhdueshëm në arsim, kërkimit shkencor, kreativitetit dhe sipërmarrjes.</i> <i>Këshilli i studentëve shpreh mendime dhe bën propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të Universitetit Western Balkans dhe të fakulteteve, siç janë ato për planet dhe programet e studimeve, për hapjen e programeve të reja, për rregulloret e veprimtarisë mësimore, për cilësinë e shërbimeve, për nivelin e tarifave të shkollimit, për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, WBU ka krijuar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Në bazë të nenit 37, 38 të Statutit të Universitetit "Western Balkans", me propozim të Rektoratit, Senati Akademik vendosi: Miratimin e 5 anëtarëve të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë një prej të cilëve është student (Zv. President i Keshillit Studentor). Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. NJSBC harton në bashkëpunim me drejtorinë përgjegjëse për kurrikulat dhe sigurimin e cilësisë, raportin mbi rezultatet dhe gjetjet e pyetësorit institucional dhe pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies. [Evidenca Nr.3.8 Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit]. [Evidenca Nr.2.12 Paketa e instrumentave të cilësisë]. [Evidenca Nr.5.24 Emërimi i studentit në NJSBC]. [Evidenca Nr.4.15 Angazhimi i ekspertit të jashtëm në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)]. [Evidenca Nr.3.9 Vendimi për ngritjen e NJSBC]. [Evidenca Nr.3.10 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC].
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	WBU ka të ngritur NJSBC në përbërje të të cilit ka përfaqësim nga tre fakultete edhe nga studentët si dhe një ekspert të jashtëm. NJSBC funksionon në koherencë me strategjinë e WBU për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë sipas përcaktimeve në Statutin e WBU dhe Rregulloren e studimeve të Universitetit. NJSBC vlerëson në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore në njësitë kryesore të Universitetit, në përputhje me standardet e cilësisë. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, ka propozuar një paketë instrumentash vlerësues, me qëllim vlerësimin periodik të rezultateve të cilësisë së arsimit, kërkimit,

	burimeve njerëzore, financave, infrastrukturës, marrëdhënieve me publikun, marrëdhënieve ndërkombëtare, aktiviteteve sociale dhe kulturore, punimeve në kuadër të zhvillimit të cilësisë dhe aktiviteteve përmirësuese në WBU. Kjo paketë konsiston në formate vlerësimi, të kategorizuara sipas nevojës dhe rëndësisë së vlerësimit, duke institucionalizuar kulturën e cilësisë në WBU. [Evidenca Nr.4.15 Angazhimi i ekspertit të jashtëm në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)]. [Evidenca Nr.3.9 Vendimi për ngritjen e NJSBC]. [Evidenca Nr.3.10 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC]. [Evidenca Nr.2.12 Paketa e instrumentave të cilësisë]. [Evidenca Nr.6.7 Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në hartimin e programeve të reja].
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Pas shqyrtimit të RVB-së, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në WBU realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. NJSBC synon të garantojë standardet e cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit që ofron në bashkëpunim me organet dhe autoritetet drejtuese të WBU, konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, ka propozuar një paketë instrumentash vlerësues, me qëllim vlerësimin periodik të rezultateve të cilësisë së arsimimit, kërkimit, burimeve njerëzore, financave, infrastrukturës, marrëdhënieve me publikun, marrëdhënieve ndërkombëtare, aktiviteteve sociale dhe kulturore, punimeve në kuadër të zhvillimit të cilësisë dhe aktiviteteve përmirësuese në WBU. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë sigurohet gjithashtu nëpërmjet sondazheve me studentët, vlerësimit të performancës së stafit si dhe ka përpiluar pyetësorin për vlerësimin e programit të studimit nga studentët e diplomuar. [Evidenca Nr.2.12 Paketa e instrumentave të cilësisë]. [Evidenca Nr.3.11 Lista e aktiviteteve trajnuese të realizuara sipas rekomandimeve të NJSBC]. [Evidenca Nr.2.13 Pyetësor për vlerësimin e programit të studimit nga studentët që diplomohen].
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të	WBU e ka tashmë një politikë të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit, e cila synon të

matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	sigurojë dhe të përmirësojë jo vetëm cilësinë e programeve të studimit, por dhe të krijojë një kulturë vijuese të cilësisë në nivel institucional.			
Konkluzione	[Evidenca Nr.2.12 Paketa e instrumentave të cilësisë]. [Evidenca Nr.4.12 Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit]. <i>Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. NJSBC harton në bashkëpunim me drejtorinë përgjegjëse për kurrikulat dhe sigurimin e cilësisë, raportin mbi rezultatet dhe gjetjet e pyetësorit institucional dhe pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies.</i> <i>Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, ka propozuar një paketë instrumentash vlerësues, me qëllim vlerësimin periodik të rezultateve të cilësisë së arsimit, kërkimit, burimeve njerëzore, financave, infrastrukturës, marrëdhënieve me publikun, marrëdhënieve ndërkombëtare, aktiviteteve sociale dhe kulturore, punimeve në kuadër të zhvillimit të cilësisë dhe aktiviteteve përmirësuese në WBU. Kjo paketë konsiston në formate vlerësimi, të kategorizuara sipas nevojës dhe rëndësisë së vlerësimit, duke institucionalizuar kulturën e cilësisë në WBU.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike	Në WBU janë krijuar njësitet në nivel departamenti dhe fakulteti që ndjekin, vlerësojnë, monitorojnë, shqyrtojnë dhe rishikojnë programet e studimit të ciklit të parë përfshirë dhe programin e studimit Bsc në "Infermieri", koordinojnë dhe bashkërendojnë ndërmjet tyre por edhe me strukturat e Universitetit aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë.

të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.

Vetëvlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe cilësore nga burime të ndryshme, me qëllim përmirësimin e mësimnxënjes së studentëve dhe vlerësimin e përmbushjes së standarteve akademike.

Disa nga instrumentat e vetëvlerësimit janë:

- Raporti Vjetor i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë "2023-2024";
- Vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës Akademik;
- Pyetësi i studentëve për cilësinë e programit mësimor e Mësimdhënien;
- Pyetësi i studentëve për cilësinë e shërbimeve të ofruara nga stafi ndihmës akademik dhe administrativ

Formulari i vlerësimit të programit nga studentët që diplomohen plotësohet nga çdo student në përfundim të ciklit të studimit (Bachelor, Master, Program i Integruar). Vlerësimi kërkon të dhëna nga studentët që diplomohen në lidhje me programin e studimit që kanë ndjekur në Western Balkans University, nivelin e njohurive që kanë përfituar dhe me mundësinë e përdorimit të këtyre njohurive për punësim, brenda dhe jashtë vendit. Të dhënat e siguruar nëpërmjet këtij vlerësimi shërbejnë për të gjykuar mbi cilësinë e programit dhe për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Në përfundim të çdo semestri akademik, marrja e mendimeve të studentëve mbi çdo program studimor në tërësi, lëndë të veçantë, pedagog apo mbi një problem specifik nëpërmjet pyetësorëve të veçantë, ndikon drejtpërdrejtë në sigurimin e cilësisë në këtë institucion. Të dhënat e fituara nga pyetësorët, pas përpunimit, shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit në tërësi, gjatë të cilit drejtuesit e institucionit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik dhe marrin masat përkatëse për përmirësim.

Përmbajtja e pyetësorit është standarte dhe është organizuar në 16 pyetje, të matshme dhe të vlerësueshme, sipas një shkalle vlerësimi nga 1 (minimumi i vlerësimit) deri në 5 (maksimumi i vlerësimit).

Gjithshtu, në një seksion të veçantë të pyetësorit, studentët kanë mundësinë të bëjnë komente për problemet që ata mendojnë për lëndën dhe/ose pedagogun përkatës. Plotësimi i pyetësorëve nga studentët është realizuar në periudhën Prill-Qershor 2024 nëpërmjet platformës

	SMART, në mënyrë konfidenciale dhe anonime. 52 pyetësorë janë plotësuar nga studentët e programit Bachelor in Nursing (EN). Raporti, në përfundim të tij, ju prezantohet organeve kolegjiale të WBU-së dhe publikohet me synim marrjen e informacionit dhe përdorimin e tij në interesin më të lartë të performancës akademike institucionale. [Evidenca Nr.2.13 Pyetësor për vlerësimin e programit të studimit nga studentët që diplomohen]. [Evidenca Nr.6.8 Formular për vlerësimin e personelit akademik nga kolegët]. [Evidenca Nr.2.12 Paketa e instrumentave të cilësisë]. [Evidenca Nr.3.6 Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik]. [Evidenca Nr.4.12 Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit].
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Të dhënat e vlerësimit përfshihen në raportet vjetore të departamentit dhe WBU. Në mbledhjet e departamentit ku analizohen të dhënat e vlerësimit hartohet dhe plani i masave për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë. Plan i masave është i detyrueshëm për të gjithë personelin akademik që angazhohet në programin e studimit. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit, përfshirë Përgjegjesit të departamentit dhe Dekanin të Fakultetit. [Evidenca Nr.3.6 Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik]. [Evidenca Nr.4.12 Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit]. [Evidenca Nr.6.5 Udhëzimi për nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor].
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të	Institucioni përdor instrumenta të drejtpërdrejta për: Vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies- me anë të formularit “Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët”, i cili realizohet me studentët nga Departamenti dhe Dekanati; Vlerësimin e kurrikulës nga komisionit i ngritur në nivel departamenti në çdo fillim viti për kontrollonin dhe vlerësimin cilësor të teksteve dhe dispensave që rekomandohen për studentët, si dhe literatura e rekomanduar.

provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Vlerësimi nëpërmjet provimeve (kolokiume) të cilat kryhen në kuadër të vlerësimit të vazhduar osë të kontrollit të programuar të dijeve. Vlerësimin e njohurive praktikë gjatë kohës që kryejnë praktikën profesionale në repartet e qendrës spitalore. Vëzhgime në auditor (në raste specifike), etj. [Evidenca Nr.2.12 Paketa e instrumentave të cilësisë]. [Evidenca Nr.3.6 Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik]. [Evidenca Nr.2.13 Pyetësor për vlerësimin e programit të studimit nga studentët që diplomohen].
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Departamenti, në kuadër të përmirësimit të cilësisë, merr të dhëna nëpërmjet intervistave me studentët aktualë dhe komunikimeve me studentët e diplomuar (alumni). Këtij qëllimi i shërbejnë edhe intervistat me personelin akademik dhe ndihmës akademik, punëdhënësit dhe institucionet në të cilët janë punësuar të diplomuarit tanë (qendrat spitalore, qendrat shëndetsore). Për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit institucioni përdor një numër instrumentash vlerësimi. Një vend të rëndësishëm në këtë vlerësim zë informacioni i përpunuar nga zyra e këshillimit të karrierës dhe alumni. Kjo zyrë do të përpunojë informacionin e plotë mbi punësimin e studentëve pas diplomimit, brenda apo jashtë vendit. Po ashtu, përmes kësaj zyre do realizohet “gjurmimi” i studentëve që do të përfundojnë këto programe studimi për evidentimin e pozicioneve të punësimit apo kualifikimet e mëtejshme pas përfundimit të programit të studimit. Duke qenë se janë në vitet e para të funksionimit të universitetit, Zyra e Alumnit nuk disponon të dhëna për punësimin e të diplomuarëve. Brezi i parë i programit Master i Shkencave në “Infermieri” do të diplomohet këtë vit akademik, ndërsa brezi i parë i programit Bachelor në “Infermieri” dhe “Fizioterapi” do të diplomohet vitin e ardhshëm. Aktualisht në Programin e Studimit: “Bachelor” në “Infermieri” në prag diplomimi për Vitin akademik: “2024-2025” janë 22 studentë të Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë në vit të tretë. Institucioni bashkëpunon dhe merr informacion për programin e studimit dhe nga drejtuesit dhe mbikqyrësit e praktikave profesionale.

	Për përmirësimin e programit të studimit dhe përshtatjen me tregun e punës institucioni është përfshirë në disa projekte internacionale.			
	[Evidenca Nr.6.9 Studentët në prag diplomimi].			
Konkluzione	Në WBU janë krijuar njësitë në nivel departamenti dhe fakulteti që ndjekin, vlerësojnë, monitorojnë, shqyrtojnë dhe rishikojnë programet e studimit të ciklit të parë përfshirë dhe programin e studimit Bsc në "Infermieri", koordinojnë dhe bashkërendojnë ndërmjet tyre por edhe me strukturat e Universitetit aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë. Në përfundim të çdo semestri akademik, marrja e mendimeve të studentëve mbi çdo program studimor në tërësi, lëndë të veçantë, pedagog apo mbi një problem specifik nëpërmjet pyetësorëve të veçantë, ndikon drejtpërdrejtë në sigurimin e cilësisë në këtë institucion. Për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit institucioni përdor një numër instrumentash të tërthorta vlerësimi. Një vend të rëndësishëm në këtë vlerësim zë informacioni i përpunuar nga zyra e këshillimit të karrierës dhe alumni.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	NJSBC është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat pasi diskutohen imtësisht me aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë miratohen nga Senati Akademik. Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit është organi përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik. Harton standarde të sigurimit të cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë, të cilat miratohen nga Senati Akademik. Mbikëqyr zbatimin e politikave,

	procedurave dhe standardeve për sigurimin e brendshëm të cilësisë në universitet. Përbëhet nga të paktën tetë anëtarë: a. Kryetar i Komisionit; b. Një anëtar i personelit akademik me kohë të plotë nga çdo njësi kryesore, me të paktën gradën shkencore "Doktor/PhD" dhe pa detyra drejtuese të nivelit të lartë; c. Të paktën dy anëtarë të personelit administrativ; d. Një përfaqësues i të diplomuarve të Universitetit; e. Një ekspert i jashtëm me përvojë të spikatur në çështjet e sigurimit të cilësisë; f. Kryetari i Këshillit Studentor për çështjet e sigurimit të cilësisë. Statutit të Universitetit "Western Balkans", me propozim të Rektorit, Rektorati ka vendosur: Ngritjen e grupit të përbashkët të punës prej 13 anëtarësh (5 me titull Prof.Dr., 1 me titull Prof., 1 me titull Prof.Asoc., 4 me titull Dr., 2 me titull Msc) Universitetin e Cambridge, për përgatitjen e Programit të Integruar të Ciklit të Dytë të Studimeve "Master i Shkencave në Mjekësi". [Evidenca Nr.3.8 Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit]. [Evidenca Nr.4.15 Angazhimi i ekspertit të jashtëm në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)]. [Evidenca Nr.6.7 Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në hartimin e programeve të reja].
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Njësitë, individët studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit, kanë të përcaktuara përgjegjësi e detyra konkrete, për të cilat mbledhen herë pas here dhe diskutojnë për përmirësimin e vazhdueshëm të problemeve që dalin. Departamenti mundëson dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre veprimtarive. Sigurimi i brendshëm i cilësisë kryhet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, strukturë e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kompetencat e Njësies së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë parashikuar në Statutin e Universitetit Western Balkans. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u takua me aktorë të rëndësishëm të jetës akademike, Dekanin e WBU,

	Përgjegjësen e Departamentit të Infermierisë, Përfaqësues të Stafit Akademik, me Grupin e Vetëvlerësimit me përfaqësues të NJSBC dhe Zyrës së Karrierës. Në këto takime u evidentua organizimi i mirë i punës së përditshme dhe koordinimi në procesin e akreditimit, përgjegjësia dhe entuziazmi për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuara qartë detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë. GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces ishin të bashkuar dhe koordinuar për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre. Institucioni tregoi aftësi menaxhuese dhe drejtuese largpamëse dhe përforcoi ndjesinë pozitive se stafi jep më të mirën duke punuar e bashkëvepruar konform rregullave, në harmoni të plotë. Studentët u shprehën entuziastë për programin e studimit. Ata referuan se janë të përfshirë në vetëvlerësim përmes pyetsorëve, propozimeve të këshillit studentor si dhe përmes përfaqësuesve të tyre në GVB. [Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike]. [Evidenca Nr.3.7 Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit]. [Evidenca Nr.3.8 Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit]. [Evidenca Nr.3.9 Vendimi për ngritjen e NJSBC]. [Evidenca Nr.3.10 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC].
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe	NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore. GVJ vlerëson si dokumentacion të rëndësishëm: Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e NJSBC. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë mbështetet në zbatim të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 37, 38 të Statutit të Universitetit Western Balkans.

studentëve e programit të studimit.	Është strukturë e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Gjithashtu, kjo rregullore synon rregullimin e procesit të vlerësimit të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe çdo shërbim tjetër në Universitetin "Western Balkans" që lidhet me zhvillimin e cilësisë, ngritjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, aplikimin, zhvillimin dhe vlerësimin e tij, miratimin e treguesve të cilësisë gjatë proceseve të vlerësimit të jashtëm.
	[Evidenca Nr.1.1 Statuti i Universitetit "Western Balkans"]. [Evidenca Nr.3.10 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC]. [Evidenca Nr.1.3 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike]. [Evidenca Nr.2.12 Paketa e instrumentave të cilësisë]. [Evidenca Nr.6.4 Formular i vetëvlerësimit të stafit]. [Evidenca Nr.6.7 Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në hartimin e programeve të reja]. [Evidenca Nr.5.28 Praktikë mbledhjeje me pjesëmarrës përfaqësuesin e klasës (Senatorin) e programit të studimit në Njësinë Bazë].
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Parimi bazë që udhëheq procesin e vlerësimit është respektimi i integritetit akademik dhe shmangia e çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. [Evidenca Nr.2.12 Paketa e instrumentave të cilësisë].
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në	Në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë marrin pjesë bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit por dhe që janë të interesuara për cilësinë (mjekë të klinikave shtetëore dhe private, etj), të cilët japin mendime dhe ekspertizë të vlefshme në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e tij, duke qënë pjesë aktive e këtij procesi.

lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.				
Konkluzione	<i>NJSBC është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat pasi diskutohen imtësisht me aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë miratohen nga Senati Akademik. Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit është organi përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik. Harton standarde të sigurimit të cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë, të cilat miratohen nga Senati Akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Strategjia e WBU ka prioritet sigurimin e cilësisë sipas standardeve ndërkombëtare dhe parashikon akreditime ndërkombëtare dhe akreditim kombëtar. Duke qenë se WBU ofron disa programe të rregulluara në fushën e shëndetësisë, të cilat janë shumë të kërkuara në tregun ndërkombëtar të punës, WBU synon t'u ofrojë të diplomuarve në këtë fushë mundësinë për të marrë provimin e licencimit pranë një autoriteti ndërkombëtar, i cili do të çojë në njohjen e plotë të studimeve universitare të WBU-së, në vende të tjera dhe t'u japë të diplomuarve të drejtën të aplikojnë pranë autoritetit ndërkombëtar menjëherë pas licencimit për të punuar në profesionin përkatës. Ekselencia në mësimdhënie, kërkime dhe transferim kërkon gjithashtu menaxhim dhe vetëqeverisje moderne të WBU-së, e cila parashikohet në strategji përmes zbatimit të sistemeve moderne të menaxhimit të cilësisë dhe përdorimit të të dhënave të krahasimit për vendimmarrje.

	Reflektimi i arritjeve të ish-studentëve të WBU-së në faqen e internetit dhe në rrjetet sociale luan një rol jetik në krijimin e imazhit më të mirë të mundshëm të Universitetit. Për të krijuar një Sistem të Menaxhimit të Cilësisë WBU në planin strategjik kryen aktivitetet: a) Njohja me sistemet e Menaxhimit të Cilësisë në universitetet ndërkombëtare. b) Përshtatja dhe miratimi i një sistemi të Menaxhimit të Cilësisë nga vendimmarrësi i WBU-së. c) Trajnimi i stafit universitar në aplikimin e sistemit të Menaxhimit të Cilësisë. d) Vënia në funksion e sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, vlerësimi periodik i rezultateve dhe bërja e përmirësimeve të nevojshme ose të mundshme. Organizimi, strategjia dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Bsc në "Infermieri" janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit e këtij procesi. [Evidenca Nr.1.4 Plani Strategjik i WBU-së "2023-2030"]. [Evidenca Nr.3.6 Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik].
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 3 (tre) janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore, një për çdo fakultet, 1 (një) ekspert i jashtëm dhe (një) përfaqësues i Këshillit Studentor. Procesi i realizimit të pyetësorëve dhe hartimi i raportit mbi gjetjet e tij është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore si: - Ligji Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Nenet 46, 103, 104 dhe 106, - Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë, miratuar me VKM nr. 824, datë 24.12.2021, "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", - Standardet dhe Udhëzimet Europiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, - Statuti i Universitetit "Western Balkans" (Nenet 37 dhe 38), - Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans" (Neni 15), - Manuali i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) përsistemin e brendshëm të cilësisë.

	Rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit Bsc në “Infermieri” bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit, pa anashkaluar dhe respektuar lirinë dhe etikën akademike. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në Programin Bachelor në Infermieri (Shqip) është vlerësuar me një mesatare prej 4.7 pikë, ku 6.9% e pedagogëve (2 pedagogë) janë vlerësuar me 1.00-3.00 pikë, 6.9% e pedagogëve (2 pedagogë) dhe 25% e pedagogëve (27 pedagogë) janë vlerësuar me 4.51-5 pikë. [Evidenca Nr.3.6 Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik]. [Evidenca Nr.6.12 Kodi i Etikës për Stafin Akademik dhe Administrativ WBU]. [Evidenca Nr.3.36 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale].
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Rezultatet e vlerësimit shoqërohen me një plan masash, në adresë të mangësive e dobësive të evidentuara dhe synojnë përmirësimin e tyre në një kohë sa më të shpejtë të mundur. [Evidenca Nr.3.13 Lista e plotë dhe raporti i trajnimeve 2022-2023, 2023-2024]. [Evidenca Nr.3.14 Trajnime të organizuara online mbi përdorimin e SMART WBU]. [Evidenca Nr.3.15 Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit Smart-WBU]. [Evidenca Nr.6.13 Pyetësor për vlerësimin e nevojave për trajnime nga personeli akademik].
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Departamenti vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin që kanë veprimtaritë për monitorimin e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit Bsc në “Infermieri”. Pyetësori për vlerësimin e nevojave për trajnime nga personeli akademik është hartuar nga “Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë” (NJSBC). Të dhënat e tij shërbejnë për organizimin e planit të punës për trajnime dhe zhvillim profesional të personelit të WBU. Plotësimi i pyetësorit është anonim. Trajnimet e planifikuara për Stafin Akademik, Janar 2024 deri në Qershor 2024, WBU Trajnimet ▪ Hapat e hapjes së një qendre apo instituti. Ndërtimi i revistës shkencore.

	▪ Cost Action, etj. Programet e Shkëmbimit. ▪ Formulari i aplikimit për projektet Erasmus+ CBHE. ▪ Plotësimi i buxhetit për projektet Erasmus+ CBHE. ▪ Metodologjia e mësimdhënies dhe efektet e saj në të nxënëit cilësor, Diversiteti dhe Ndërgjegjësimi Kulturor - Dallimet kulturore, festimi i diversitetit dhe promovimi i përfshirjes, Përshtatja ndaj ndryshimit, etj. ▪ Rendesia e Vlerësimit. Planifikimi, zbatimi dhe përmirësimi i vlerësimit në arsimin e lartë. Vlerësimi. ▪ Ndërmjetësimi dhe zgjidhja e konfliktit. Komunikim efektiv, bashkëpunim dhe Bashkepunim në grupe. ▪ Komunikimi efektiv shkencor. Kërkim shkencor, publikim dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore. ▪ Si të shkruhet teza, Msc. Udhëzues praktik për shkrimin e disertacionit dhe tezës. ▪ Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale/Patentat. ▪ Analiza e të dhënave për kërkimin shkencor. ▪ Trajnim për mediat transmetuese. ▪ Sigurimi i cilësisë në Arsimin e Lartë, Paketa e Instrumenteve të Sigurimit të Cilësisë në WBU. ▪ Konferenca Ndërkombëtare, Arsimi i Lartë dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm. ▪ Konferenca Ndërkombëtare, Mjekësi Inovative: Mjekësia, Inovacioni dhe Teknologjia. Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Statutit të Universitetit "Western Balkans", si dhe të Rregullores Themelore, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë i propozon Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike miratimin e kërkesave të stafit për rimbursim të shpenzimeve mbi pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare. [Evidenca Nr.3.13 Lista e plotë dhe raporti i trajnimeve 2022-2023, 2023-2024]. [Evidenca Nr.3.19 Model i mbështetjes financiare të personelit në pjesëmarrje në aktivitete kërkimore shkencore].
--	--

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Departamenti organizon vazhdimisht veprimtari me pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentët për përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit Bsc në "Infermieri". Qëllimi i këtyre veprimtarive është ndërgjegjësimi i tyre për rëndësinë e këtij procesi. [Evidenca Nr.3.13 Lista e plotë dhe raporti i trajnimeve 2022-2023, 2023-2024]. [Evidenca Nr.3.19 Model i mbështetjes financiare të personelit në pjesmarrje në aktivitete kërkimore shkencore]. [Evidenca Nr.6.6 Model aplikimi për project (AKKSHI&CBPHE)]. [Evidenca Nr.6.14 Organizimi i Spring Fest]. [Evidenca Nr.3.18 Lista e ekspertëve dhe profesorëve të angazhuar në trajnime në WBU gjatë vitit akademik 2022-2023].			
Konkluzione	<i>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 3 (tre) janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore, një për çdo fakultet, 1 (një) ekspert i jashtëm dhe (një) përfaqësues i Këshillit Studentor. Departamenti vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin që kanë veprimtaritë për monitorimin e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit Bsc në "Infermieri". Departamenti organizon vazhdimisht veprimtari me pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentët për përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit Bsc në "Infermieri". Qëllimi i këtyre veprimtarive është ndërgjegjësimi i tyre për rëndësinë e këtij procesi</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
--	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------------------

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në

"Infermieri" të ofruar nga Universiteti "Western Balkans"

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Kurrikula e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në: "Infermieri" është hartuar bazuar në modelet më të mira kombëtare dhe evropiane, duke respektuar standardet dhe kornizën ligjore në fuqi.
2. Personeli përgjithësisht është i kualifikuar dhe me përvojë për zbatimin e programit.
3. WBU bashkëpunon me Spitalin Amerikan, Spitalin Hygeia dhe Cambridge Clinical Laboratories ku kryhen praktikat profesionale, në kuadër të formimit të plotë teorik dhe praktik të studentëve (për të cilat ekzistojnë dhe kontratat përkatëse), të cilat garantojnë zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike, në sajë të mjediseve të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme.
4. WBU ofron programe të studimeve të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës të cilat ndihmojnë individët në rritjen e kualifikimit të tyre dhe të aftësive profesionale.
5. EPIC është një projekt që i përshtatet më së miri vizionit të WBU një universitet i gjeneratës së katërt, për zhvillimin dhe aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara. Një pikë e fortë e WBU në këtë drejtim janë edhe mundësitë që janë krijuar praktikave dhe njohurive që përfitojnë përmes programit EPIC, një mundësi kjo unike në Shqipëri.
6. Mjediset mësimore të Universitetit "Western Balkans" si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë më të fundit të informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.
7. Struktura akademike e Fakultetit dhe e Departamentit, përgjegjës për programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Infermieri" ka përvojën, kapacitetet burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në këtë fushë.
8. Pjesa më e madhe e kurrikulës mbulohet nga personel akademik me kohë të plotë dhe një pjesë e vogël nga personel akademik me kontratë. Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie është brenda standardeve të përcaktuara në legjislacion (70% PAE dhe 30% PAK).
9. Programi i studimit ofrohet në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.
10. Universiteti "Western Balkans", si një institucion i ri me vizion të gjerë, i kushton rëndësi vlerësimit, përmirësimit dhe përdorimit të metodave të ndryshme mësimdhënies.
11. Qëndrueshmëria e personelit akademik është edhe një nga synimet e rëndësishme të parashikuara në politikat e zhvillimit të stafit akademik të WBU.
12. Për realizimin me sukses të objektivave të programeve të studimit në WBU janë angazhuar edhe personel ndihmës- akademik me karakter akademik.
13. Pjesëmarrje aktive në trajnime për rritjen e aftësive profesionale.

14. Ndërkombëtarizimi i universitetit jo vetëm përmes angazhimit të personelit akademik dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione jashtë vendit, por edhe përmes prurjes në Shqipëri të studentëve nga vende të ndryshme është një prioritetet i rëndësishëm i WBU.
15. Këshilli i studentëve promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të Universitetit Western Balkans.
16. Biblioteka e WBU garanton tekste mësimore cilësore dhe literaturë plotësuese të mjaftueshme në sasi dhe cilësi. Biblioteka e Universitetit është e bazuar në kurrikulën universitare. Burimet e pasura të bibliotekës mund të aksesohen nga Staf i akademik dhe administrativ dhe studentët e Bibliotekës.
17. WBU vlerëson si të rëndësishëm edhe komunikimin digjital, duke siguruar një paketë transparence të plotë përmes faqes së web-it, dhe në rrjetet sociale të universitetit (Facebook, Instagram), me informacione të detajuara mbi të gjithë ofertën akademike, personelin akademik të angazhuar në këto programe studimi, tarifat e studimit, bashkëpunimi me institucionet partnere, mundësitë e bursave të studimit, rregulloret institucionale, vlerësimet periodike, dhe çështje të tjera me interes.
18. Nëpërmjet platformës SMART-WBU, institucioni disponon digjitalizimin e dokumentacionit sipas njësive prodhuese.

Pika të dobëta:

1. Literatura e rekomanduar e përdorur, jo gjithmonë është e përditësuar në edicione të viteve të fundit; (Standarti II.3, kriteri 4; Standarti IV.3, kriteri 2)
2. Zhvillimi i praktikave profesionale të realizohet në spitale shtetërore dhe në mjediset e shërbimit parësor ; (Standardi II.2, kriteri 2, Standarti V.3, kriteri 4)

Rekomandime:

1. GJVJ rekomandon të rishihet mundësia e rritjes së personelit akademik me kualifikim në fushën e Infermierisë.
2. GJVJ rekomandon që titullarët e lëndëve të jenë të kategorisë profesor.
3. GJVJ rekomandon shpërndarjen e ngarkesës sipas formimit profesional dhe titullit të kualifikimit të personelit akademik.
4. GJVJ rekomandon plotësimin e syllabuseve që kanë mungesë të literaturës të rekomanduar, apo bazë dhe të mundësojnë unifikimin e syllabuseve sipas një formati standart për të gjitha lëndët e programit.
5. GJVJ rekomandon të krijohet mundësia e nënshkrimit të marrëveshjes me QSUT për zhvillimin e praktikave profesionale edhe në spitale shtetërore.
6. GJVJ rekomandon që Rregulloret e programeve mësimore të jenë të veçanta për secilin program studimi. Nuk mund të jetë e njëjta rregullore si për bachelor ashtu dhe për master.
7. GJVJ rekomandon që Rregullorja e programit mësimor, e Njesisë Bazë dhe asaj Kryesore duhet të kenë në përmbajtjen e tyre: Misionin: Organizimin e provimit të

diplomës: sezonet e diplomimit: kush përcakton datat e diplomit: nqs studenti nuk kalon provimin final, kur është mundësia e rradhës, etj.

8. GVJ rekomandon që të realizohen marrëveshje për bashkëpunim për projekte Erasmus +, që si studentët dhe stafi të kenë mundësi shkëmbimi eksperiencash.
9. GVJ rekomandon që të krijohen marrëveshje me shërbimin parësorin, pasi këta infermierë të ardhshëm duhet të kenë dhe një përgatitje praktiko-profesionale në sistemin parësor.
10. GVJ rekomandon që të planifikohet dhe zhvillimi i praktikave në mjediset e shërbimit parësor pasi produkti i këtij programi studimi është infermier që mund të punojë në qendra shëndetësore.
11. GVJ rekomandon që Njësia bazë të përshtasë kurrikulën me ndryshimet në bazë të VKM 823, datë 28. 12. 2023 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar!
12. GVJ konsideron se orët e praktikës profesionale duhet të jenë më të shumta.

Conclusions of the Evaluation of the first cycle Bachelor's study program in "Nursing" offered by the Higher Education Institution "Western Balkans University".

Strengths and affirmations:

1. The curriculum of the first cycle Bachelor's study program "Nursing" has been designed based on the best national and European models, respecting the standards and legal framework in force.
2. The staff is generally qualified and experienced in implementing the program.
3. WBU collaborates with the American Hospital, Hygeia Hospital and Cambridge Clinical Laboratories where professional practices are carried out, within the framework of the complete theoretical and practical training of students (for which there are also relevant contracts), which guarantee the development of professional practices and other practical activities, thanks to sufficient, appropriate and special environments.
4. WBU offers continuing education study programs, as a form of lifelong learning that help individuals increase their qualifications and professional skills.
5. EPIC is a project that best fits the vision of WBU as a fourth-generation university, for the development and practical application of acquired knowledge and skills. A strong point of WBU in this regard is also the opportunities that have been created for practices and knowledge that are obtained through the EPIC program, a unique opportunity in Albania.
6. The learning environments of the "Western Balkans" University, such as classrooms, laboratories, studios and other environments, are equipped with electronic tools and the latest information technology, which guarantee the realization of the theoretical and practical learning process, through the use of contemporary teaching-learning methodologies and technologies.

7. The academic structure of the Faculty and the Department, responsible for the first cycle study program "Bachelor" in "Nursing" has the experience, capacities and resources necessary in the specific academic field to offer a study program in this field.
8. The majority of the curriculum is covered by full-time academic staff and a small part by contract academic staff. The academic staff engaged in teaching is within the standards set out in the legislation (70% PAE and 30% PAK).
9. The study program is offered in two languages, Albanian and English.
10. Western Balkans University, as a new institution with a broad vision, attaches importance to the evaluation, improvement and use of various teaching methods.
11. The sustainability of the academic staff is also one of the important goals foreseen in the WBU academic staff development policies.
12. For the successful implementation of the objectives of the study programs at WBU, academic assistant-academic staff with an academic character have also been engaged.
13. Active participation in trainings to increase professional skills.
14. The internationalization of the university not only through the engagement of academic staff and cooperation agreements with institutions abroad, but also through the bringing of students from different countries to Albania is an important priority of WBU.
15. The Student Council promotes student participation and coordinates their representation in the governing bodies of Western Balkans University.
16. The WBU Library guarantees quality textbooks and supplementary literature sufficient in quantity and quality. The University Library is based on the university curriculum. The rich resources of the library can be accessed by the academic and administrative staff and the students of the Library.
17. WBU also considers digital communication to be important, providing a complete transparency package through the university's website and social networks (Facebook, Instagram), with detailed information on the entire academic offer, academic staff engaged in these study programs, study fees, cooperation with partner institutions, scholarship opportunities, institutional regulations, periodic assessments, and other issues of interest.
18. Through the SMART-WBU platform, the institution has the digitalization of documentation according to production units.

Weak points:

1. Some syllabi did not contain all the elements in accordance with VKM No. 41, dated 24.01.2018; **(Standard II.3, criterion 4;)**
2. The recommended literature used is not always updated in recent editions; **(Standard II.3, criterion 4; Standard IV.3, criterion 2)**

3. Development of professional practices also in state hospitals; (Standard V.3, criterion 4)

Recommendations:

1. GVJ recommends reviewing the possibility of increasing the number of academic staff with qualifications in the field of Nursing.
2. GVJ recommends that the heads of courses be of the professor category.
3. GVJ recommends distributing the workload according to the professional training and qualification title of the academic staff.
4. GVJ recommends completing the syllabi that lack recommended or basic literature and enabling the unification of the syllabi according to a standard format for all subjects of the program.
5. GVJ recommends creating the possibility of signing an agreement with QSUT for the development of professional practices in state hospitals as well.
6. GVJ recommends that the Regulations of the teaching programs be separate for each study program. There cannot be the same regulation for both bachelor and master.
7. GVJ recommends that the Regulations of the curriculum, the Basic Unit and the Main Unit should include in their content: Mission: Organization of the diploma exam: graduation seasons: who determines the diploma dates: if the student does not pass the final exam, when is the next opportunity, etc.
8. GVJ recommends that cooperation agreements be made for Erasmus + projects, so that both students and staff have the opportunity to exchange experiences.
9. GVJ recommends that agreements be created with the primary service, since these future nurses must also have a practical-professional preparation in the primary system.
10. GVJ recommends that the development of practices in primary service settings be planned since the product of this study program is a nurse who can work in health centers.
11. GVJ recommends that the Basic Unit adapt the curriculum to the changes based on VKM 823, dated 28. 12. 2023 "On the elements of study programs offered by higher education institutions", as amended!
12. GVJ considers that the hours of professional practice should be more numero

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

